

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5638  
E hënë, 26 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

Përrurohen shtatorët  
e tre liderëve historikë  
të Prizrenit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**PRESIDENTI UDHËTOI PËR  
VIZITË ZYRTARE NË SHBA** F. 3

**SOT MBAHET MBLEDHJA E  
PËRBASHKËT E DY QEVERIVE  
KOSOVË - SHQIPËRI** F. 3

**SKENDERAJ BËHET GATI PËR  
FESTIMIN E 28 NËNTORIT** F. 10

## EKONOMI

**82 PËR QIND TË  
INVESTIMEVE KAPITALE  
TË NIVELIT QENDROR,  
VAZHDIMËSI NGA PROJEKTET  
E KALUARA** F. 8

**LEKAJ: QYTETARËT T'I  
DENONCOJNË RASTET E  
KEQPËRDORIMEVE GJATË  
TESTEVE PËR PATENTSHOFER** F. 9

## KULTURË

**LIBRI  
'LANTUMIRË  
BACA ADEM',  
NJË SINTEZË E  
SHKRUAR ME  
NJË STIL TË  
QARTË** F. 12



Prof. dr. Ibrahim  
GASHI

## SPORT

**GJIMNASTIKA NDERON  
FESTËN E FLAMURIT** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", ADRI NURELLARI

## Dialogu duhet të vazhdojë me çdo kusht

FAQE 4-5

Politologu Adri Nurellari ka bërë me dije se, pavarësisht prej përplasjeve me Serbinë, Kosova duhet të vazhdojë për normalizim të marrëdhënies në mes të dy shteteve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse Kosova do të dilte si penguese e

këtij procesi do ta humbte shumë reputacionin në arenën ndërkombëtare. Nurellari ka treguar se nëpërmjet dialogut Kosova nuk negocion vetëm me Beogradin, por edhe me partnerët perëndimorë. Sipas tij, Kosova nuk duhet ta humbë rastin historik për të

bërë një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, e cila do të sillte njohje të ndërsjellë. Ai ka vlerësuar se zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Evropian ka shumë gjasa ta transformojnë radikalisht BE-në dhe ta bëjnë më indiferente ndaj Ballkanit

**Veseli bashkon  
Degën e PDK-së  
në Skenderaj, i  
pranishëm edhe  
Bekim Jashari** | FAQE 6



## Kurti kërkon zbatimin e marrëveshjeve Kosovë - Shqipëri

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të dielën ka kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Në një konferencë për media ai ka thënë se deri më tani për dhjetëra marrëveshje të nënshkuara ka pasur vetëm zotim, por jo edhe zbatim të tyre. Sipas Kurtit, në vend të paradave të bashkimit në mbledhje ceremoniale, Kosova e Shqipëria duhet të krijojnë një frymë bashkëpunuese,



të konkretizuar në mekanizma të përbashkët | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Presidenti Thaçi udhëtoi për vizitë zyrtare në ShBA

Gjatë qëndrimit në Uashington, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, do të zhvillojë një takim me këshilltarin për Siguri Kombëtare, John Bolton dhe me Sekretarin e Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo. Thaçi ka thënë se me zyrtarët amerikanë do të bisedojë rreth arritjes së një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, e cila, sipas tij, do t'i mundësonte Kosovës një ulëse në Kombet e Bashkuara, anëtarësim në NATO dhe BE

**PRISHTINË, 25 NËNTOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të dielën për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Gjatë qëndrimit në Uashington, presidenti Thaçi do të zhvillojë takime me përfaqësues të lartë të Shtëpisë së Bardhë, të Departamentit të Shtetit, Kongresit, Senatit, si dhe me personalitete që kanë mbështetur rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Në Shtëpinë e Bardhë presidenti Thaçi do të zhvillojë një takim me John Boltonin, këshilltar për Siguri Kombëtare i presidentit të ShBA-së,

Donald Trump. Presidenti Thaçi, po ashtu, do të takohet edhe me sekretarin e Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo.

Në këto takime presidenti Thaçi do të bisedojë për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve, për perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila i siguron Kosovës njohje nga Serbia dhe i hap rrugë për anëtarësim në BE, NATO dhe OKB.

Presidenti Thaçi do të ketë takime të shumta edhe me kongresistë dhe sena-

torë amerikanë, të cilët në dy dekadat e fundit e kanë mbështetur Kosovën. Po ashtu, presidenti Thaçi në Dallas do të ketë një takim të veçantë edhe me ish-presidentin e ShBA-së, George W. Bush, si dhe me komunitetin shqiptar amerikan.

Vizita e presidentit Thaçi në Uashington vjen në një periudhë të rëndësishme për vendin, ku Kosova është duke bërë përpjekje për konkretizimin e perspektivës euroatlantike dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, e cila duhet të rezultojë me njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB.

### LAJME SHKURT

#### Basha : "Unaza e re", projekt korruptiv

**TIRANË, 25 NËNTOR** - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ishte i pranishëm edhe të dielën në protestën e banorëve të zonës së Astirit, të cilët preken nga projekti për ndërtimin e "Unazës së re". Në fjalën e tij, Basha tha se "nesër do të publikojmë fakte të reja për këtë projekt korruptiv. Edi Rama duhet të tërhiqet urgjentisht nga ky projekt megavjedhje. Prokuroria nuk ekziston, nuk ka, se po të kishte prokurori, ky djalë që u rrah, ata që e rrahën, do të kishin frikë nga prokurorët". "Është i njëjti segment, i pari është ndërtuar me 8 milionë euro për një kilometër, ky tani do ndërtohet me 20 milionë euro për një kilometër. Është një vjedhje ashikare, 20 milionë euro një kilometër. Një nga kompanitë këtu është regjistruar në parajsë fiskale. Edi Rama që t'i vjedhë këto para kërkon të nxjerrë këta njerëz nga shtëpitë", ka theksuar Basha.

Kreu i PD-së, Basha, ka dënuar edhe dhunën që, sipas tij, ka ushtruar policia ndaj banorëve të "Astirit", mes të cilëve edhe të miturve. Ndërkohë, dhjetë nga 11 të arrestuarit pas protestës së banorëve të "Astirit" para Parlamentit, janë liruar të dielën nga Gjykata e Tiranës, në një seancë që ka zgjatur rreth 3 orë e 30 minuta. Por, një prej tyre, Dorian Protoduari, i cilësuar nga policia si organizatori i protestës që degjeneroi në dhunë e përplasje mes banorëve dhe policisë, ka mbetur në qeli. Ndaj 10 personave të tjerë është caktuar masa e sigurisë "detyrim me paraqitje". Arrestimi ndodhi ndërkohë që pranë të lënduarve gjendej deputeti i PD-së, Klevis Balliu, i cili vrapoi pas policëve deri te mjeti dhe aty pati një konflikt verbal me ta. Deputeti Balliu u bëri thirrje policëve ta lënë protestuesin pasi kishte nënën në operacion, pasi ishte dëmtuar në protestë.

#### Vuçiqi: Serbia nuk u pushtua asnjëherë

**BEOGRAD, 25 NËNTOR** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se Serbia nuk është pushtuar asnjëherë dhe, sipas tij, për këtë do të binden edhe ata që sot po përpiqen ta bëjnë. "Ju mendoni se Serbia është shtypur, por unë kam diçka për të thënë. Serbia e njeh forcën e saj dhe ne e dimë se Serbinë nuk ka arritur askush ta pushtojë, as edhe ata që sot janë duke u përpjekur", ka thënë Vuçiqi. Këtë deklaratë Vuçiqi e bëri gjatë një ceremonie e cila u mbajt në Novi Sad dhe pak ditë pas marrjes së vendimit unanim nga Qeveria e Kosovës, për vendosje të taksës 100 % ndaj produkteve serbe dhe atyre të Bosnjë e Hercegovinës.

## Zaevi: S'kam pasur kurrfarë komunikimi me Gruevskin

**SHKUP, 25 NËNTOR** - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka mohuar kontaktin me ish-kryeministrin në arrati, Nikolla Gruevski, para se ky i fundit të largohet nga

Maqedonia drejt Hungarisë. Zaevi thotë se nëse do të ndodhte një bisedë e tillë mes tyre, kjo me automatizëm do të konsiderohej si ikje me marrëveshje. "Me

Gruevskin prej kur jam kryeministër, nuk kam kurrfarë kontakti. Kontaktet e fundit ishin kur Kuvendi ishte robëruar, bllokuar në atë diskutimin e pafund para

se të ndodhnin ngjarjet e padëshirueshme më 27 prill. Ajo ndodhi aty, në Kuvend, kur biseduam ta zhbloktonim procesin, se ishte e qartë që ekzistonte shumica

dhe të mos e keqtrajtonim Maqedoninë dhe institucionet e Maqedonisë. Atëherë ndodhën bisedat e fundit", tha kryeministri maqedonas Zoran Zaev.

## Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur konferencë për medie

# Kurti kërkon zbatimin e marrëveshjeve Kosovë - Shqipëri

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të dielën ka kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Në një konferencë për media ai ka thënë se deri më tani për dhjetëra marrëveshje të nënshkruara ka pasur vetëm zotim, por jo edhe zbatim të tyre. Sipas Kurtit, në vend të paradave të bashkimit në mbledhje ceremoniale, Kosova e Shqipëria duhet të krijojë një frymë bashkëpunuese të konkretizuar në mekanizma të përbashkët



Shqipërisë tregon sa prapambetjen e bashkëpunimit, aq edhe mungesën e vizionit për zhvillim në të dyja anët e kufirit. Në këtë kontekst, ai ka thënë se prej dy qeverive ende nuk kanë një strategji të përbashkët për një sektor të rëndësishëm siç është energjia. Sipas Kurtit, kapitali shtetëror i Shqipërisë dhe i Kosovës, bashkë me kapitalin nga diaspora, do të mund të përdorej për ta modernizuar industrinë e naftës në Shqipëri dhe për ta vënë atë në funksion të zhvillimit ekonomik të të dy vendeve.

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 25 NËNTOR** - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë të dielën se Kosova dhe Shqipëria kanë nevojë për krijimin e një fryme bashkëpunuese të konkretizuar në mekanizma të përbashkët, por jo për parada bashkimi në mbledhje ceremoniale. "Nuk na duhet nacionalizëm elektoral, as paradë bashkimi e sfilatë qeveritarësh në mbledhje ceremoniale, sa na duhet themelimi i një fryme bashkëpunuese të konkretizuar në institucione e mekanizma të përbashkët, me synim konkret dhe me ndikim sektorial: komisione të përbashkëta qeveritare dhe parlamentare për siguri kombëtare, politikë të jashtme dhe burime të përbashkëta natyrore, pastaj treg i përbashkët për prodhimet, mallrat, shërbimet dhe bizneset

në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në përputhje me interesin kombëtar dhe praktikën e BE-së, mandej nga treg i përbashkët dhe dogana të përbashkëta, konsullata e ambasada të përbashkëta, shkolla të përbashkëta ushtarake e policore, strategji zhvillimore të përbashkëta sepse jemi komplementarë (përplotësues), program i njësuar arsimor etj", ka deklaruar Kurti të dielën në një konferencë me gazetarë. Ai ka theksuar se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë shpie te fuqizimi i ndërsjellët drejt integritimit e bashkimit tonë dhe, sipas Kurtit, kjo është në frymën evropiane dhe i kontribuon paqes e kohezionit.

Ai ka thënë se deri më tani Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar dhjetëra marrëveshje, memorandume e pajtime, por për to ka vetëm zotim dhe jo

zbatim. "Pra, sado që nënshkruhen këto marrëveshje, nga pikëpamja e zbatueshmërisë në secilin prej vendeve, referuar ligjeve përkatëse për marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kushtetutave e akteve nënligjore për fushëveprimin normativ të qeverive, këto marrëveshje në rendin juridik të secilit vend janë në shkallën më të ulët. Praktikisht, siç e shohim, ato nuk është e thënë të zbatohen dhe as nuk ka ndonjë mekanizëm që përbën detyrim për t'i zbatuar a respektuar nga qeveria në qeveri a nga shteti në shtet. Marrëdhëniet vëllazërore nuk po funksionojnë në asnjë nga marrëveshjet për zbatueshmëri", është shprehur Kurti. Ai ka treguar se katër vjet më vonë Kosova ende nuk e ka zbatuar marrëveshjen për heqjen e

lejeve të punës për shtetasit e Shqipërisë, ndonëse Shqipëria i ka hequr ato menjëherë pas nënshkrimit në vitin 2014. Sipas Kurtit, qeveritë e Kosovës ka thënë, njëra pas tjetrës, se duhet të ndryshohet ligji për të huajt në Kosovë, por kur u ndryshua ligji, kjo marrëveshje nuk u përfshi në të. "Ky është një nga shembujt ilustrues dhe jo i vetmi. Gati secila marrëveshje apo memorandum e ka një dimension të tillë, pra: zotim pa zbatim. Ato zhduken menjëherë pas konsumit mediatic. Ose, flitet për mërgatën e përbashkët, për një diasporë, por ku janë qendrat e përbashkëta kulturore, ku është furnizimi me tekste shkollorë në shqip për mërgatën?", ka theksuar ai. Kurti ka vlerësuar se aktualisht tregtia në mes të Kosovës dhe

Në këtë konferencë për medie, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka folur edhe për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh për produktet serbe, duke thënë se duhet të priten efekte pozitive të saj, ndonëse metoda nuk është adekuate dhe përgatitjet mungojnë. "Ne besojmë se bojkotimi i produkteve të Serbisë, reciprociteti i plotë me Serbinë, duhet të jetë parim, që për pasojë do të kishte moslejimin e hyrjes së mallrave të Serbisë", ka deklaruar Kurti.

I pyetur lidhur me qëndrimin e Shqipërisë sa i përket vendosjes së kësaj takse, ai ka thënë se Shqipëria në politikën e vet të jashtme karshi Serbisë duhet ta ndjekë Kosovën. "Ne jemi një komb në dy shtete. Nuk mund t'i kemi dy politika karshi Serbisë", ka thënë Kurti.

## Sot mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive Kosovë - Shqipëri



Prishtinë, 25 nëntor - Sot (e hënë) në qytetin e Pejës mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës kanë bërë me dije se në këtë mbledhje të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë pritet të arrihen disa marrëveshje në fusha të ndryshme. Me këtë rast zëvendëskryeministri i Kosovës

dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka treguar se në takimin e dy qeverive do të trajtojnë tema të ndryshme, do të bëjnë një analizë se çka është bërë deri tani dhe do të kenë disa marrëveshje të reja që do të jenë me rëndësi për të ardhmen e të dyja vendeve. Ai ka treguar se ka pasur vështirësi për konkretizimin e

marrëveshjeve të arritura në takimet e mëparshme të dy qeverive, por beson se kjo logjikë do të ndryshojë në të mirë të dy vendeve. "Ne jemi të vetëdijshëm dhe dëshmitarë që edhe sot e kësaj dite njerëzit e rëndomtë kanë vështirësi në komunikimin e tyre në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, kanë pengesa të çuditshme të paarsyeshme,

vonesa, pengesa të panevojshme, maltretime të njohjes së dokumenteve, krejt të panevojshme. Besoj se këto dy qeveri njëherë e mirë duhet të fillojnë ta lehtësojnë qarkullimin e njerëzve, qarkullimin e mallrave, krijimin e lehtësirave, heqjen e barrierave të panevojshme, heqjen e taksave të panevojshme. Po shpresoj se mbledhja e qeverive në Pejë do të

jetë pikënisje e një ndryshimi të thellë të bashkëpunimit, për të cilin është shumë me rëndësi të zhvillohet", ka thënë Limaj për "KosovaPress".

Ai ka treguar se një nga pikat e rendit të ditës në mbledhjen e dy qeverive është njohja e certifikatave apo licencave që lëshohen në Tiranë dhe në Prishtinë.

Flet për "Epokën e re", Adri Nurellari

# Dialogu i Brukselit duhet

## - Njëpërmjet dialogut Kosova nuk negocion vetëm me Beogradin, por edhe me partnerët perëndimorë

Politologu Adri Nurellari ka bërë me dije se, pavarësisht prej përplasjeve me Serbinë, Kosova duhet ta vazhdojë për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse Kosova do të dilte si penguese e këtij procesi do ta humbte shumë reputacionin në arenën ndërkombëtare. Nurellari ka treguar se njëpërmjet dialogut Kosova nuk negocion vetëm me Beogradin, por edhe me partnerët perëndimorë. Sipas tij, Kosova nuk duhet ta humbë rastin historik për të bërë një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, e cila do të sillte njohje të ndërsjellë. Ai ka vlerësuar se zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Evropian ka shumë gjasa ta transformojnë radikalisht BE-në dhe ta bëjnë më indiferente ndaj Ballkanit

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 NËNTOR -

**"Epoka e re":** Z. Nurellari, presidenti i vendit po vazhdon fazën finale të dialogut me homologun serb në Bruksel, ani pse pozita dhe opozita ende nuk kanë arritur një pajtuesmëri për këtë çështje. Si duhet të veprohet tani?

**Nurellari:** Ajo që është e rëndësishme është ta kemi nivelin më të lartë të mundshëm të vetëdijesimit të elitës politike, por edhe të mbarë elitës së shoqërisë për rëndësinë që ka ky dialog për Kosovën si dhe për momentin e rëndësishëm historik i cili nuk duhet humbur. Historia bashkëkohore është e mbushur me raste ku janë humbur momente historike në negociata për paqe e ato rrethana të favorshme nuk janë përsëritur për një kohë të gjatë. Kështu, për shembull plani i Koffi Annanit i vitit 2004 ishte një mundësi e shkëlqyer për të pasur një paqe në Qipron e ndarë, mirëpo mospërqaftimi i asaj mundësie ishte një humbje e jashtëzakonshme, sepse rrethanat e favorshme të asaj kohe nuk janë ripërsëritur ende tani që kanë kaluar 14 vjet prej dështimit të asaj marrëveshjeje. Një alamet mundësie e humbur për tragjedinë siriane ishte edhe ujdia që u sugjerua prej rusëve në vitin 2012 në negociatat e drejtuara nga Annan në Gjenevë, por që u refuzua prej Perëndimit. Tanimë pozita e Asadit, falë ndërhyrjes ruse, veç është konsoliduar edhe më shumë e opozita siriane pothuaj është shfarosur dhe, dashur e pa dashur, ato terma që u propozuan atëherë janë imponuar sot në terren në teatrin e luftës. Ndërkaq, qindra mijëra civilë janë vrarë e

miliona të tjerë janë shpërngulur, duke shkaktuar një ndërkrizat më të mëdha bashkëkohore humanitare të refugjatëve. Pra, ne duhet të vëmë mësim nga pësimet e vendeve të tjera dhe ta shikojmë me më shumë seriozitet e angazhim mundësinë e tanishme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë.

**"Epoka e re":** Në këtë jave kanë ndodhur zhvillime dramatike në raportet në mes të dy vendeve. Kemi parë ofensivën diplomatike serbe në Dubai, e cila ia pamundësoi Kosovës anëtarësimin në Interpol. Përgjigjja e institucioneve tona ishte ngritja e taksës për mallrat serbe nga 10 në 100 për qind. A mund të vazhdohet dialogu në këtë situatë?

**Nurellari:** Dialogu apo komunikimi mes palëve kundërshtare vazhdon edhe në mesin e luftës. Madje zanafilla e të drejtës ndërkombëtare dhe organizatave multilaterale ndërshtetërore është pikërisht komunikimi mes palëve për t'u kujdesur për të vrarët e të plagosurit e fushëbetejës, çka solli edhe krijimin e kryqit të kuq dhe konventës së Gjenevës një shekull e gjysmë më parë. Po ashtu, Kissinger ka pasur një duzinë raunde negociatash me vietkongët mu në mes të nxehtësisë së luftës në Vietnam derisa u arritën Akordet e Paqes së Parisit më 1973. Edhe negociatat e sipërpërmendura të Gjenevës bëheshin ndërkohë që palët ndërluftuese i shkaktonin qindra të vrarë njëra-tjetrës në Siri. I jap këta shembuj për të treguar që edhe në mes të luftës së ashpër zhvillohen bisedime e jo më në rrethanat e një konflikti të ngrirë siç e kemi ne. Prandaj, pavarësisht prej fërkimeve e përplasjeve, të cilat shpesh janë

edhe mesazhe apo forma të komunikimit ndërmjet palëve në kuadër të negociatave, dialogu duhet të vazhdojë me çdo kusht. Alternativa e dialogut është vetëm lufta.

**"Epoka e re":** Një pjesë e kritikëve të dialogut mendojnë se nuk duhet të vazhdohet ky proces për sa kohë Serbia nuk dëshmon me veprime vullnetin e mirë për marrëveshje. Cili është reagimi juaj ndaj këtij opinioni?

**Nurellari:** Unë e kuptoj këtë frustrim dhe maraz që është akumuluar, mirëpo një çështje delikate si dialogu, dhe në përgjithësi marrëdhëniet me jashtë të një shteti, kërkojnë mendje të ftohta e të kthjellëta e jo reagime impulsive, emocionale dhe rrethanore. Nëse Serbia nuk dëshmon vullnet të mirë, atëherë nuk do të thotë që edhe ne të biem në të njëjtin nivel, por duhet të tregojmë epërsi morale e vullnet të mirë pavarësisht prej Serbisë. Shoqëria jonë duhet të kuptojë diçka tjetër gjithashtu. Ne njëpërmjet dialogut nuk negociojmë vetëm me Beogradin, por edhe me partnerët tanë perëndimorë. Në një farë mënyre ne nuk duam thjesht ta transformojmë marrëdhënien tonë me Beogradin, por edhe të japim mesazhe në Bruksel, DC e në mbarë arenën ndërkombëtare që shteti ynë i ri është paqedashës dhe synon t'i zgjidhë mosmarrëveshjet njëpërmjet dialogut e mirëkuptimit. Nëse do të dilnim ne si pengues të dialogut e paqes, do të humbim shumë reputacion në arenën ndërkombëtare. Duhet, po ashtu, të kuptohet se hapësira e manovrimit të Kosovës në politikën e jashtme është goxha e kufizuar, sepse kushtëzohet nga brishtësia jonë si shtet dhe nga rrethana



të tjera të pafavorshme ndërkombëtare që janë aty jo për faj të Kosovës. Për Kosovën është shumë e rëndësishme ta çimentojë miqësinë dhe partneritetin me ShBA-në dhe partnerët e tjerë perëndimorë të cilët janë vendimtarë në hapat tanë të mëtejshëm. Mjafton të shikojmë çfarë ka ndodhur vitin e kaluar me disa popuj të tjerë në përpjekjet e tyre për pavarësi për të kuptuar se sa të bekuar kemi qenë prej këtij partneriteti. Katalunjasit në Spanjë, që janë pothuaj 6 milionë e, po ashtu, 6 milionë kurdë të Irakut, bënë referendume e shpallën pavarësinë vitin e kaluar, e pa përkrahje ndërkombëtare të dy këto nisma dështuan plotësisht.

**"Epoka e re":** Disa prej kritikëve të Thaçit thonë se ai po e shtyn përpara këtë proces prej frikës nga Gjykata Speciale. Qëndron

kjo, meqenëse ju keni qenë edhe këshilltar i presidentit?

**Nurellari:** Kjo është një ndër gjërat më të ulëta që thuhet në Kosovë dhe dëshmon për një degradim të thellë moral të një segmenti të shoqërisë sonë. Të thuash këtë gjë do të thotë se besohet se pretendimet absurde të Dik Martit janë të vërteta. Pra, të besohet se ka bërë luftë të pistë UÇK-ja e cila me luftën e saj të pastër e dinjtoze fitoi simpatinë dhe mbështetjen e vendeve kryesore të botës demokratike. Po ashtu, do të thotë që të mos besohet në proceset e njëpasnjëshme të Gjykatës së Hagës, të UNMIK-ut e të EULEX-it që kanë vërtetuar pafajësinë e drejtuesve të UÇK-së dhe kanë hedhur poshtë prej kohësh akuzat për të cilat është ndërtuar Gjykata Speciale. Përpos kësaj, këta zëra në njëfarë mënyre nxjerrin në pah edhe

# të vazhdojë me çdo kusht



natyrën frikacake të personave që i artikulojnë këto pretendime të cilët mendojnë se, meqenëse ata kanë frikë nga hija e vet kur ecin në mbrëmje, edhe ish-komandantët janë të kushtëzuar nga frika në veprimet e tyre politike. Është qesharake të thuhet se themeluesit e UÇK-së dhe aktivistët e hershëm të ilegales, të cilët kanë vepruar me kurajë në robëri e në luftë të pabarabartë, të kenë frikë sot në liri e demokraci.

**"Epoka e re":** Ideja e presidentit Thaçi për korrigjimin e kufirit me Serbinë nuk ka marrë përkrahjen e spektrit politik të brendshëm. Po ashtu, kjo ide ka nxitur reagime të shumta e të ndryshme ndërkombëtare për shkak të frikës së krijimit të një precedenti të ri në rajon?

**Nurellari:** Ideja nuk ka marrë përkrahjen e një pjese të spek-

trit politik të brendshëm, që ka dëshmuar se anti-thaçizmin e ka të vetmin kalë beteje dhe motiv politik. Këtë gjë e pamë me krijimin e koalicionit VLAN në vitin 2014, ku parti që kishin sulmuar e akuzuar për kohë të gjatë njëra-tjetrën, u bënë bashkë për pushtet dhe me një emërues të përbashkët, anti-thaçizmin. Pra, mund të them se një pjesë e mirë e zërave kundërshtues e bëjnë këtë gjë ose si pasojë e hatërmbetjeve apo inateve të kultivuara prej kohësh ndaj Thaçit, ose sepse e shikojnë si mundësi për të fituar më shumë pikë në kuadër të përpjekjeve për pushtet. Për sa iu përket zërave ndërkombëtarë, unë mendoj se ngelet ende për t'u parë cili ka për të qenë pozicioni i tyre kur të ketë një bocë apo draft marrëveshje konkrete, sepse sot ende jemi në fazën e deklaratave dhe spekulimeve mediatike.

Kuptohet që BE-ja nuk është thjesht vëzhguese, por palë në këto negociata, sepse jo vetëm i lehtëson ato, por edhe do të dalë garant për zbatimin e marrëveshjes që do të dalë prej tyre. Prandaj nuk mendoj se do të ketë një marrëveshje finale që nuk do të jetë filtruar e miratuar njëherë paraprakisht nga Brukseli e Uashingtoni. Nëse do të kemi një marrëveshje finale, ajo me siguri do ta ketë marrë paraprakisht miratimin te partnerët ndërkombëtarë përpara se të nënshkruhet e të shkojë drejt ratifikimit.

**"Epoka e re":** Në bazë të zhvillimeve aktuale, si njohës i mirë marrëdhënieve ndërkombëtare, sa janë gjasat që vitin tjetër të kemi një marrëveshje përfundimtare në mes të Serbisë dhe Kosovës?

**Nurellari:** Unë nuk jam në brendësi të procesit, por mund

të hamendësoj se gjasat më të mëdha janë që nëse ka mirëkuptim mes palëve, marrëveshja përfundimtare të realizohet në fillim të vitit të ardhshëm, pasi që kjo marrëveshje të finalizohet, aprovohet paraprakisht nga faktorët e rëndësishëm ndërkombëtarë, nënshkruhet nga Kosova e Serbia, mandej promovohet e ratifikohet. Është e domosdoshme që të kemi një Bashkim Evropian funksional i cili luan një rol kyç në të gjitha këta hapa. Viti që vjen është një vit elektorale sepse më 23-26 maj do të mbahen zgjedhjet e Parlamentit Evropian nga i cili do të derivojnë edhe drejtuesit e rinj të institucioneve evropiane. Fushata ka për të nisur formalisht në mars 2019, ndërsa sesioni i fundit parlamentar ka për të qenë në 18 prill. Pra, duke nisur nga marsi, institucionet e BE-së kanë për të qenë disfunktionale derisa të zgjidhen drejtuesit e rinj. Një ndër arsyt pse kam thënë më herët që ky është moment historik, është fakti se zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Evropian kanë shumë probabilitet që ta transformojnë radikalisht BE-në që njohim ne sot nëpërmjet triumfit të partive populiste. Këto parti jokonvencionale ekstremiste populiste, të së majtës e të djathtës, tashmë kanë korrur sukses dhe eklipsuar në zgjedhjet parlamentare apo presidenciale të vendeve kryesore të BE-së dhe me gjasa i njëjti sukses do të përsëritet edhe në zgjedhjet e Parlamentit Evropian. Nëse kjo gjë do të ndodhë atëherë ne do të kemi një BE shumë më indiferente ndaj Ballkanit dhe që do të përqendrohet te problemet e brendshme e do të dominohet nga retorika kundër zgjerimit, kundër emigrantëve, islamofobe apo karakteristika të tjera të valës së populizmit që po dominon në Evropë.

**"Epoka e re":** A duhet Kosova ta synojë arritjen e një marrëveshje me Serbinë, pavarësisht prej kostos?

**Nurellari:** Kurrsesi jo. Nuk duhet të ketë marrëveshje me çdo kusht. Kosova tashmë e ka shpallur pavarësinë e saj 10 vjet më parë dhe ka derdhur boll gjak që ekzistenca saj të mos vendoset më në Beograd. Këtu bëhet fjalë për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht të obligueshme, me kushte të pranueshme nga të dy palët, që do ta garantojë njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve të pavarura si dhe një

paqe afatgjatë. Pra, duhet të shmangen qëndrimet ekstreme emocionale. Nuk duhet as të mos biem në kryeneçësi duke thënë që s'kemi nevojë fare për marrëveshje me Serbinë pa na përmbushur ata neve paraprakisht një sërë kushtesh e as në disfatizëm e inferioritet duke thënë se na duhet një paqe medoemos duke gëlltitur çfarëdo kostoje që vjen me të. Këtu kërkohet një pozicion i ekuilibruar, realist, largpamës, me këmbë në tokë, që duhet të vijë pas një informimi të mirë jo vetëm me rrethanat tona, por edhe me praktikën më të mira ndërkombëtare.

**"Epoka e re":** Çfarë ndodh nëse nuk nënshkruajmë një marrëveshje. A ka Kosova kosto apo pasoja nga mosnënshkrimi?

**Nurellari:** Në çdo rast, kuptohet se varet nga marrëveshja për të cilën bëhet fjalë. Vetëm njohja me termat e plotë e marrëveshjes së propozuar mund t'i japë mundësi dikujt që të gjykojë nëse ka kosto më të madhe me lëshimet e bëra në këtë marrëveshje apo me mosnënshkrimin e saj. Megjithatë, në parim mund të thuhet, pa asnjë mëdyshje, se çdo ditë që kalon në kushtet e konfliktit të ngrirë me Serbinë, përbën një barrë të drejtpërdrejtë për Kosovën dhe qytetarët e saj. Kostot janë të shumta, u përkasin shumë sferave të jetës dhe janë të përmasave të mëdha. Mungesa e një zgjidhje për konfliktin cenon imazhin tonë dhe mban larg investitorë potencialë. E kemi të vështirë të përfitojmë siç duhet nga globalizimi i sotëm për sa kohë e kemi njohjen ndërkombëtare të kufizuar dhe nuk mund të kemi qasje të plotë në qarkullimin ndërkombëtar të lirë të mallrave, shërbimeve, kapitaleve e njerëzve. Mosqenia në OKB e shumë organizata ndërkombëtare na jep kosto oportune për të përfituar nga veprimtaritë apo mundësitë që ofrohen nga këto organizata. Mjafton t'i kujtojmë kostot e bizneseve duke mos pasur mundësinë e standardit ISO apo koston e qytetarëve me kartonin e gjelbër sa për të krijuar një ide. Ngelja peng e së kaluarës së konfliktit të ngrirë ka edhe kosto për politikën e brendshme, sepse e pengon edhe evoluimin e diskursit politik të brendshëm dhe ripërtëritjen e elitave politike me gjak të ri. Pra, janë të panumërta arsytet apo përfitimet që do të kishte Kosova nga një marrëveshje finale e pranueshme.

## Një muaj paraburgim ndaj tre të dyshuarve në lidhje me vrasjen e Ivanoviqit

**MITROVICË, 25 NËNTOR (ER)** - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën prej një muaji paraburgim ndaj dy të pandehurve me initiale N. S dhe M. R., të dyshuar për veprën penale "vrasje e rëndë", lidhur me vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviq. Ndërkaq, të pandehurit D. M. po ashtu i është caktuar masa prej një muaji paraburgim për veprën "zbulim i fshehtësisë zyrtare". "Të pande-

hurve N. S., M. R. dhe D. M. u është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji për secilin veç e veç, nga data 23. 11. 2018 deri më 23. 12. 2018", është thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore.

Policia e Kosovës, me kërkesë të Prokurorisë Speciale, javën e kaluar (të premten) ka arrestuar katër persona në veri të Mitrovicës, tre prej të cilëve janë të dyshuar se

kanë lidhje me vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviq. Ndërkaq, personi i katërt i arrestuar nuk ka të bëjë me rastin Ivanoviq. Gjykata Themelore ka njoftuar se masa prej një muaji paraburgim "është masë adekuate dhe e domosdoshme në këtë fazë të procedurës, për sigurimin e pranisë së tyre në procedurën penale dhe zhvillimin e papenguar të procedurës". Në njoftimin e gjykatës theksohet se

masa e paraburgimit prej një muaji parandalon që të pandehurit të qëndrojnë në liri ku "do të mund t'i përsërisnin veprat e njëjta apo të ngjashme penale".

Policia e Kosovës ka njoftuar se është në kërkim edhe të një personi tjetër me initiale M. R., i përkatësisë serbe, lidhur me vrasjen e Ivanoviqit.

Politikani serb, Oliver Ivanoviq, ishte vrarë më 16 janar 2018, para



selisë së partisë së tij në Mitrovicën Veriore. Ai ishte kryetar i Iniciativës Qytetare "Liria, Demokracia dhe Drejtësia".

## Veseli unifikon degën e PDK-së në Skenderaj, i pranishëm edhe Bekim Jashari

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**SKENDERAJ, 25 NËNTOR (ER)** - Të dielën në restorantin "Arbëri" në Skenderaj, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është takuar me bashkëluftëtarë dhe bashkëpartiakë, para nisjes së zgjedhjeve të brendshme në Degën e PDK-së në këtë komunë. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari.

Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka bërë me dije, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", se në këtë takim përçuan mesazhin e unitetit të Degës së PDK-së në Skenderaj. "Para nisjes së zgjedhjeve të brendshme përçuan mesazhin e unitetit të degës më të madhe të PDK-së. Skenderaj përherë do të jetë bastion i PDK-së, e cila është adresa politike e Drenicës dhe gjithë Kosovës. Kryetari i Komunës, Bekim Jashari, e begatoi këtë takim", ka thënë Haxhiu.

Përmes një deklarate për media kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka folur për këtë takim. "Si kryetar i Komunës së Skenderajt, si anëtar i familjes Jashari dhe si i pavarur që kam garuar në zgjedhjet e fundit, do të jem gjithmonë i pranishëm aty ku ka bashkim. Vetëm të



bashkuar, kur tejkalojmë interesat e mundshme afatshkurta, mund të ecim përpara drejt realizimit të synimeve tona si shtet dhe si komb. Kam deklaruar gatishmëri të bashkëpunoj me çdo njeri e secilën parti politike. I vlerësoj të gjithë për mbështetjen që kanë ofruar për ta zhvilluar komunën tonë. Dhe, kështu, i pavarur do të vazhdoj të jem në shërbim të të gjithëve që ia duan të mirën Skenderajt tonë", ka thënë Bekim Jashari. Kohët e fundit në Degën e

PDK-së në Skenderaj ka pasur pakënaqësi, madje disa asamblistë të kësaj partie janë përjashtuar nga partia e cila drejtohet nga Kadri Veseli. Tani PDK-ja është në zgjedhje të brendshme partiake, ku nga ky proces do të shihet se sa unike mund të dalë kjo parti, sidomos në bastionin e saj në Drenicë.

Pas një periudhe disajavëshe nga hapja e procesit zgjedhor, pas përgatitjeve dhe shumë aderimeve të reja, PDK-ja ka filluar të dielën procesin e

zgjedhjeve të strukturave të reja për Dekadën e Re, ndërsa kuvendi i parë zgjedhor ka filluar në nëndegën Korishë të Prizrenit.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se ky proces zgjedhor do ta hapë dhe modernizojë PDK-në, e cila, sipas tij, ka transformuar dhe e ka zhvilluar Republikën e Kosovës. "Procesi i zgjedhjeve në PDK nuk është thjesht proces zgjedhor partiak, por e definon të ardhmen e shtetit tonë për Dekadën e Re. Prandaj, është

shumë me rëndësi që në këtë proces zgjedhor të marrin pjesë dhe përgjegjësi njerëzit më të mirë të vendit tonë. Kemi nevojë të fuqizohemi edhe më shumë si parti, sepse sa më e fuqishme të jetë Partia Demokratike, aq më e fuqishme dhe e fortë do të jetë Kosova", ka thënë Veseli. Ai i ka ftuar të gjithë intelektualët dhe njerëzit e mirë të Komunës së Prizrenit që të bëhen pjesë e procesit zgjedhor dhe të marrin përgjegjësi për të mirën e Prizrenit dhe të Kosovës.

## Përkujtohet ballafaqimi i parë frontal i UÇK-së me policinë pushtuese serbe

**SKENDERAJ, 25 NËNTOR (ER)** - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përkujtuar të dielën ballafaqimin e parë frontal të UÇK-së me policinë pushtuese serbe që ka ndodhur në Rezallë të Skenderajt 21 vjet më parë. Në nderim të kësaj beteje, Veseli, i shoqëruar nga disa bashkëluftëtarë, ka nderuar prijësin e kësaj

beteje, komandantin legjendar të UÇK-së, Adem Jashari. Veseli ka thënë se vetëm të bashkuar mund ta zhvillojnë Kosovën dhe ta bëjnë më të fortë shtetin e pavarur dhe sovran. "21 vjet më parë, në Rezallë të Re të Skenderajt, ndodhi ballafaqimi i parë frontal i UÇK-së me policinë pushtuese serbe. Ajo beteje hoqi përfundimisht të gjitha dilemat rreth luftës sonë

çlirimtare dhe kështu shërbeu si paralajmërim i saj. Në nderim të kësaj beteje, me shumë bashkëluftëtarë, nderuam prijësin e kësaj beteje, komandantin legjendar të UÇK-së, Adem Jasharin. Duke qenë të bashkuar, e fituam lirinë. Dhe, të bashkuar do ta zhvillojmë Kosovën dhe do ta bëjmë më të fortë shtetin tonë të pavarur dhe sovran", ka thënë Veseli të dielën.



Në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është bërë inaugurimi i shtatoreve të tri figurave kombëtare, Ymer Prizrenit, Abdyl Frashërit dhe Sylejman Vokshit

## Përurorohen shtatoret e tre liderëve historikë të Prizrenit

Janë përuruar shtatoret e tre liderëve historikë, Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri dhe Sylejman Vokshi, në kuadër të shënimit të Vitit Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, në Kompleksin Monumental të Lidhjes së Prizrenit. Përurimi i shtatoreve u bë nga Ilir Meta, Kadri Veseli, Edi Rama, Ramush Haradinaj dhe Mytaher Haskuka

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

**PRIZREN, 25 NËNTOR** - Në qytetin e Prizrenit të dielën janë përuruar shtatorët e liderëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri dhe Sylejman Vokshi. Në përurimin e këtyre shtatoreve kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe personalitete të tjera nga të dyja shtetet.

Me rastin e vendosjes në qytetin e Prizrenit të shtatoreve të tre drejtuesve të shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni dhe Sulejman Vokshi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli,

ka thënë se këto shtatore përjetësojnë një çast vendimtar në historinë tonë kombëtare: momentin kur këta tre burra të mëdhenj e bashkuan kombin përballë rreziqeve të kohës. Duke e konsideruar këtë ditë të veçantë për Prizrenin dhe gjithë kombin shqiptar, Veseli ka thënë se në mesin tonë po kthehen të përjetësuar tre baballarë të kombit, të cilët nisën rrugëtimin me idenë e lirisë dhe të shtetit kombëtar të shqiptarëve.

Ai ka shtuar se kjo ditë nuk do ta kishte këtë hijeshi, pa një histori tjetër të veçantë të kombit tonë, e cila ndodhi këtu e 21 vjet më parë, pra ballafaqimi i parë frontal i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, e cila për herë të parë poshtëroi në mënyrë disfatiste ushtrinë dhe policinë serbe. "Sot ne shqiptarët

kemi shtete, kemi liri, identitet e krenari, por kemi edhe partnerë, në rrugëtimin tonë drejt integriteteve euroatlantike. Do të vazhdojmë kështu si sot, të bashkuar, për të përkujtuar dhe lartësuar çdo herë veprat e atdhetarëve dhe baballarëve të kombit. Njëkohësisht, edhe për të dëshmuar se jemi të përgjegjshëm dhe të vëmendshëm për të gjitha sakrificat që janë bërë, si dhe për të ruajtur e çuar përpara amanetin e heronjve dhe martirëve të kombit. Lavdi e përjetshme heronjve të atdheut!", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se është i nderuar që po merr pjesë në ceremoninë e inaugurimit të shtatoreve të tri figurave të ndritura të rilindjes sonë kombëtare, burrështetasve dhe etërve themelues të Lidhjes



Shqiptare të Prizrenit, Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri dhe Sylejman Vokshi. "Të përfitojmë nga ky moment, të bëjmë thirrje të bashkëpunimit dhe bashkimit të të gjithë shqiptarëve në interes të prosperitetit të kombit tonë", ka thënë Meta.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni dhe Sylejman Vokshi

përhapen thirrjen për veprim në unitet në të gjitha anët e atdheut. "Porosinë e idealit të Gjergj Kastriotit për të drejtën e shqiptarëve e rizgjuan dhe e mbajtën gjallë plot një shekull e gjysmë. Shqiptarët qëndrojnë të vendosur për të drejtën e tyre të plotë, të lirë në trojet e veta dhe të bashkuar me familjen perëndimore", ka thënë Haradinaj.



### Limaj: Shqiptarët do t'i nderojnë përjetë e mot heronjtë që trasuan rrugën drejt lirisë

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se këta tre burra të mëdhenj të kombit ishin ideatorët dhe burrështetasit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Sipas tij, shqiptarët do t'i nderojnë përjetë e mot të gjithë ata që trasuan rrugën drejt lirisë. "Përgëzime autorëve të këtyre shtatoreve të cilat zbukuruan qytetin e Prizrenit! Lavdi jetës dhe veprës të Ymer Prizrenit, Abdyl Frashërit, Sylejman Vokshit dhe gjithë delegatëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit!", ka thënë Limaj.

## MPJ-ja: S'ka vendim për ndalimin e zyrtarëve të lartë të Serbisë në Kosovë

**PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)** - Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) nëpërmjet një deklarate për medie ka përgënjeshtuar raportimet e medieve serbe për të ashtuquajturën "Listë të zezë" dhe për ekzistimin e ndonjë vendimi nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës për t'iu ndaluar hyrja apo vizitat eventuale zyrtarëve më të lartë të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Kjo ministri ka shprehur keqardhje të thellë, që mediet në

shtetin fqinj, edhe dy dekada pas përfundimit të luftës, vazhdojnë të publikojnë lajme të rreme, që burojnë nga politika propaganduese e pushtetit në Serbi, duke shkelur seriozisht parimet themelore të profesionit të tyre për raportimin e lajmeve të vërteta, të sakta, të pavarura, të paanshme dhe profesionale. "Ministria e Punëve të Jashtme rikujton se për dallim nga praktikat e hartimit të 'Listave të Zeza' dhe 'personave të padëshiruar' nga shteti fqinj, që kanë përfshirë



por nuk janë kufizuar vetëm në ndalimin dhe moslejimin e hyrjes në territorin e tyre të sportistëve, artistëve, akademikëve, shtetasve ordinerë, që kanë vizituar të afërmit e tyre dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë nga Republika e Kosovës, institucionet e Kosovës kanë zbatuar në frymë dhe në shkronjë Marrëveshjen e Brukselit, e cila specifikon në mënyrë të qartë se si zhvillohen vizitat e zyrtarëve të lartë në të dyja shtetet respektive", është thënë në deklaratën e MPJ-së.

## 82 për qind të investimeve kapitale të nivelit qendror, vazhdimësi nga projektet e kaluara

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 25 NËNTOR** - Instituti GAP ka mbajtur konferencë për media të dielën, në të cilën ka prezantuar raportin me titull "Projektbuxheti 2019 - analizë e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore". Të gjeturat kryesore të analizës së buxhetit u prezantuan nga Agron Demi dhe Berat Thaqi. Raporti argumenton se projektbuxheti i vitit 2019 paraqet në masë të madhe vazhdimësi të buxheteve nga vitet e kaluara, për arsye se ngjashëm me vitet e kaluara, gati

gjysma e investimeve kapitale do të menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe shumica prej tyre do të investohen në infrastrukturë rrugore.

Gjithashtu, 82 për qind e investimeve kapitale të nivelit qendror janë vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara. Të dhënat e ndarjes së investimeve kapitale nga Ministria e Infrastrukturës sugjerojnë se ka diskriminim të komunave të qeverisura nga disa parti të cilat nuk janë të përfshira në Qeverinë e Kosovës.

Raporti thekson se është rritur dukshëm financimi i buxhetit

nga borxhi publik dhe të hyrat e AKP-së, ndërkohë që shpenzimet rrjedhëse, veçanërisht subvencionet dhe transferimet dhe mallrat dhe shërbimet, janë rritur më shpejt se ato kapitale.

Si zhvillim pozitiv në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm, dhe që përputhet edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (KE), është rritja e buxhetit për shëndetësi dhe disa institucione që merren me funksionimin e tregut. Mirëpo, buxheti i Kosovës i ndarë për shëndetësi është ende i ulët krahasuar me shpenzimet relative në shtetet e Bashkimit Evropian

(BE). Gjithashtu, edhe rritja e buxhetit për Agjencinë për Punësim dhe numri i punëtorëve në Inspektoratin e Punës janë në përputhje me sugjerimet e KE-së për Kosovën. Edhe shpenzimet në arsim janë rritur dukshëm, mirëpo ato ende mbesin në nivelin e shpenzimeve relative të shteteve të BE-së. Gjithashtu, për herë të parë është ndarë granti shtesë për kryeqytetin i cili do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve buxhetore të Komunës së Prishtinës për adresim të problemeve të të gjithë banorëve që jetojnë apo kryejnë shërbime në kryeqytet.

Në anën tjetër, në mungesë të një ligji të ri për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), ky institucion ka mbetur nën financimin e buxhetit të Kosovës edhe për vitin 2019.

Përveç subvencionimit të RTK-së, edhe kategoritë e tjera të subvencioneve, siç janë pensionet dhe kompensimet, janë rritur dukshëm, ndërsa me gjithë konstatimet për numrin e veteranëve të luftës, buxheti për këtë kategori është rritur tutje. Megjithatë, në rast se nuk do të ketë ulje të numrit të veteranëve, buxheti i ndarë për vitin 2019 do të jetë i pamjaftueshëm.



## Lekaj: Qytetarët t'i denoncojnë rastet e keqpërdorimeve gjatë testeve për patentshofer

**PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka reaguar lidhur me ankesat e një kandidati se i janë shkelur të drejtat e tij gjatë kohës kur i është nënshtruar testimit për patentshofer. Lekaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se shteti i së drejtës duhet të funksionojë dhe të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. "Shteti i së drejtës duhet të funksionojë. Të gjithë të barabartë përpara ligjit. Rasti i reagimit të njërit prej kandidatëve për t'u pajisur me

patentshofer, gjë që e ka shtyrë ta bëjë publike ecurinë dhe dyshimet e tij, është një mundësi për neve për të ripërsëritur për të disatën herë, thirrjen që me këto raste duhet të merren organet përgjegjëse, ndërsa si procedurë administrative do të marr vendim që inspektorati, divizioni që mbikëqyr këtë segment, do ta zbardhë të vërtetën nëse ka pasur shkelje të të drejtave të kandidatit në fjalë dhe ai do të provohet me komision, që të dalë e vërteta e këtij rasti", ka thënë Lekaj.



Ai ka shtuar se sa iu përket të thënave se ka korrupsion në mar-

rjen e patentshoferit, edhe në takimet e Këshillit për Siguri të

Trafikut Rrugor, ku anëtar është edhe drejtori i Policisë së Kosovës, por edhe në të gjitha rastet e tjera, ka ritheksuar t'i shkohet deri në fund dhe të zbardhet e vërteta. "Jemi për të pasur sa ma shumë transparencë jo vetëm në këtë sektor, por në të gjitha segmentet e shtetit. U bëj thirrje të gjithëve që janë përballur me të tilla raste, që të shkruajnë e të denoncojnë. Vetëm duke qenë bashkë, të gjitha hallkat e shoqërisë dhe të shtetit mund ta luftojmë të keqen", ka thënë Lekaj.



## Kusari: Taksa ndaj Serbisë nuk duhet të hiqet derisa nuk arrihet një hap pozitiv në dobi të Kosovës

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Deputetja e Kuvendit të Kosovës në radhët e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka folur për taksën doganore 100 për qind që Kosova e ka vendosur për produktet e Serbisë dhe të Bosnje dhe Hercegovinës. Sipas saj, ky vendim i Qeverisë është i domosdoshëm dhe mekanizmi i vetëm për ta kushtëzuar Serbinë.

Ish-ministrja e Tregtisë dhe Industrisë thotë se reagimet e Federica Mogherinit për taksën 100 për qind janë të njëanshme. Ajo thotë se prodhuesit e Kosovës do të përfitojnë nëse kjo masë nuk do të ndërpritet. Kusari-Lila thotë se pas vendosjes së kësaj mase dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk ka kuptim. Ajo shprehet se arrestimet në veri të Mitrovicës janë të lidhura me taksën që Qeveria e Kosovës i ka vendosur Serbisë dhe janë bërë me urdhër të presidentit Thaçi. "Prej fillimit kur Qeveria ka paralajmëruar dhe pastaj filloi zbatimin e masës prej 10 përqindësh, mendoj se ka qenë një hap i duhur. Në fakt, është i vetmi mekanizëm që Kosova mund ta aplikojë në raport me Serbinë. Herën e parë Qeveria e Kosovës ka pasur një vendim shumë të



butë, vendim simbolik. Tash ka kuptim vendimi, për arsye se ka ndikim të drejtpërdrejtë në mosblerjen apo në vështirësitë për prodhuesit serbë në plasmanin e produkteve të tyre në Kosovë. Nëse hyjmë në një rishikim të krejt asaj se çfarë kemi arritur me Serbinë deri më tash, më tepër kemi regres në vitet e fundit sesa progres. Andaj,

një masë e cila kthen në pikën në të cilën Serbia duhet ta shohë se edhe ajo ka nevojë për Kosovën, ka qenë më se e domosdoshme. Pak do të jetë e vështirë që Serbia të njohë Kosovën, ashtu siç kërkon kryeministri (Ramush) Haradinaj në këto rrethana të krijuara tash, por që është e domosdoshme që të vendoset

një kufi i asaj se çfarë është e lejueshme për të hyrë në negociatë, pastaj për uljen apo ndryshimin e kësaj mase", ka thënë Kusari-Lila.

Në pyetjen se a pret që Qeveria e Kosovës të mos zbrapset nga ky vendim pas këtyre reagimeve, Kusari-Lila tha: "Unë uroj që jo. Frikësohem vetëm në implikimet e sigurisë pas ngjar-

jeve të fundit, por kjo masë nuk duhet të hiqet përderisa nuk arrihet një hap pozitiv në dobi të Kosovës, qoftë në zbatimin e marrëveshjeve, qoftë në nivelizimin, gjegjësisht sjelljen e palëve në një pozitë pak a shumë të barabartë, sepse ne nuk e kemi një pozitë të barabartë me Serbinë dhe ajo është e dukshme".

## LB-ja kërkon largimin e Kosovës nga CEFTA



Prishtinë, 25 nëntor (ER) - Lideri i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta shqyrtojë seriozisht mundësinë e largimit nga CEFTA. Ai ka vlerësuar se kështu do të ndërtohej një pozicion parimor edhe për të negociuar si shtet i pavarur marrëveshjen e CEFTA-s dhe jo vetëm ta pranohet ajo që ka pranuar UNMIK-u në emër të Kosovës. "Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të jetë konsekuente deri në fund në veprimet e veta,

është mirë seriozisht ta trajtojë largimin nga CEFTA, në të cilën është pranuar përmes UNMIK-ut. Më pas të aplikojë në këtë organizatë rajonale si shtet, si Republikë e Kosovës. Kështu ndërtojmë pozicion parimor edhe për të negociuar si shtet i pavarur marrëveshjen e CEFTA-s dhe jo vetëm ta pranohet ajo që ka pranuar UNMIK-u në emër tonin (e duke mos na trajtuar si shtet në asnjë moment)", ka shkruar Murati në llogarinë e vet në "Facebook".

## Bie çmimi i naftës

LONDËR, 25 NËNTOR - Çmimet botërore të naftës kanë rënë në nivelin më të ulët për më shumë se një vit. Rënia e çmimit të naftës ka ndodhur tashmë për shtatë javë rresht. Çmimet e naftës tashmë janë në nivelet më të ulëta që prej tetorit të vitit 2017, teksa çmimi i naftës amerikane ka rënë në 50,42 dollarë për fuçi, e çmimi i naftës në Londër ra për 6,1 për qind, përkatësisht një fuçi naftë, më 23 nëntor, në Londër u shit për 58,8 dollarë. Furnizimi me naftë është rritur

më shpejt sesa kërkesat për naftë në muajt e fundit, duke rritur frikën se mund të ketë një ngopje me naftë, teksa vendet kryesore që prodhojnë naftë, po shqyrtojnë mundësinë që ta ulin prodhimin e tyre. Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) pret që ta shkurtojë prodhimin, pasi shtetet anëtare të mbajnë një takim më 6 dhjetor. Çmimet botërore të naftës kanë rënë në një mesatare prej 20 përqindësh deri më tani.



## Skenderaj bëhet gati për festimin e 28 Nëntorit

SKENDERAJ, 25 NËNTOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë të gjitha përgatitjet për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë. Kjo datë ndërlidhet edhe me ditëlindjen e komandantit legjendar, Adem Jashari dhe daljes publike të UÇK-së. Sheshi "Adem Jashari" në Skenderaj është stolitur me flamurin kombëtar dhe

shtetëror. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka uruar të gjithë qytetarët për festat e nëntorit. "Skenderaj ynë, me ngjyrat e flamurit të shqiptarisë, të Ismail Qemalit, Adem Jasharit dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i bërë gati për aktivitetet që na presin këto ditë. Gëzuar festat e nëntorit!", ka thënë Jashari.



## Muharremaj: Diaspora ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për vendin

SUHAREKË, 25 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, deputetët Time Kadrijaj nga AAK-ja, Glauk Konjufca nga Vetëvendosja dhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, janë takuar me bashkatdhetarët në

Itali. Muharremaj nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se diaspora ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Kosovën. "Në një takim miqësor me deputetët Time Kadrijaj, Glauk Konjufca, kryetarin e

Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe miq të tjerë, me bashkatdhetarët në Trevizo të Italisë, po takohemi në shënim të festave të 28 nëntorit. Diaspora jonë ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm dhe ne e vlerësojmë gjithmonë këtë", ka shkruar Muharremaj.



## Mërgimtarët dhe Komuna e Malishevës e bëjnë me shtëpi një veteran të UÇK-së

MALISHEVË, 24 NËNTOR (ER) - Falë ndihmës dhe kontributit të mërgimtarëve tanë që punojnë dhe jetojnë në botën e jashtme, si dhe kontributit të Komunës së Malishevës, familja e veteranit të luftës së UÇK-së, Sabit Dobruna, është bërë me shtëpi banimi dhe përfundimisht e ka zgjidhur problemin e strehimit. Për ndërtimin e shtëpisë për


veteranin Dobruna truallin e ka dhuruar mërgimtari Fatmir Gashi, ndërsa për ndërtimin e shtëpisë kanë ndihmuar edhe Arbnor Bashota, Adrian Dobruna, Faik Zogaj dhe Komuna e Malishevës. Me rastin e përfundimit të shtëpisë dhe dhënies së çelësave të shtëpisë, në vigjilje të shënimit të 28 nëntorit, kryetari i

Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i ka falënderuar të gjithë donatorët, në veçanti Fatmir Gashin për dhënien e truallit për Sabit Dobrunën, si dhe e ka uruar veteranin për shtëpinë e re. "U jam mirënjohës të gjithëve për këtë gjest human", ka thënë Begaj, duke i falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për ndërtimin e shtëpisë.

## Ferizaj organizoi mbi 150 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive

FERIZAJ, 25 NËNTOR (ER) - Në prag të edicionit të sivjetmë të festivalit "Kosovarja Këndon" dhe shënimit të 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968, ngjarje këto për të cilat në Ferizaj do të mbahen manifestime kulturore nën përku-jdesjen e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhemile Murati-Shabani, ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka prezantuar sfidat dhe sukseset e kësaj drejtorie gjatë dhjetë muajve të qeverisjes. "Ndër sukseset kryesore të kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe qeverisëse janë përmirësimi i infrastrukturës kulturore, rinore dhe sportive, krijimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore për institucionet e kulturës, në rastin konkret të

Teatrit 'Adriana', i cili për herë të parë ka hartuar statutin e këtij institucioni, po kështu edhe repertorin e shfaqjeve të këtij institucioni", ka thënë ajo. Murati-Shabani ka theksuar se shumë shpejt Ferizaj do të ketë Muzeun e Kujtesës, zotim ky i kryetarit Aliu. Duke shpalosur detaje nga aktivitetet që do të realizohen në javën e ardhshme, përkatësisht më 26 dhe 27 nëntor, drejtoresha Murati-Shabani ka folur për agjendën për shënimin e 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968, organizim ky i për-bashkët me Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës që do të mbahet më 26 nëntor, si dhe Festivalin "Kosovarja Këndon" në edicionin e 46 të tij, ku do të ketë risi, me pjesëmarrjen e artistëve nga treva të ndryshme shqiptare.



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /31/

## Letra e Rifat Krasniqit, dokumenti tjetër inkriminues



Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Letra e cila i mveshet se e ka shkruar Rifat Krasniqi, sipas "arsyetimit" që e jep Ali Shukrija, si prokuror publik i Kosovës. Letra është e shkruar me 6 prill 1945, në Rahovec. Ajo fillon me këtë fjali:

I dashtuni vëlla,  
Më ka rënë për detyr që të takohem me këtë njeri, me të cilin po ta dërgoi këtë letër, dhe njëkohësisht po të lajmëroj për situatën e këtushme.

Besoje që edhe ju jeni të interesuar me shpejtësin sikurse neve. Nuk kuptoj se si deri më tash nuk kemi mujtë me bamun asgjë. Detyrë e çdo shqiptari është që të luftojë për tokën tonë shqiptare dhe për flamurin tonë, dhe për këto pika na kemi filluar me punuar qysh me kohë.

Përveç që mundemi me ju

lajmëruar dhe me ju ditur gjerë e gjatë mbi bashk-punuasat tanë si dhe mbi organizatën tënë, por më pak fjalë po ju lajmërojmë se si duhet me punuar për lirinë e Kosovës sonë të robënueme nën thundrën e popullit Jugosllav.

Pika kryesore e organizatës është që te formoni Komitetin Nacional Demokratik në çdo komunë. Në këtë komitet duhet të hyjnë njerëzit më të besueshem prej të cilëve njëri mbetet si kryetar me disa anëtar këshilltar dhe me një sekretar. Çdo kush prej komitetit të ketë lidhje dhe të lidhet me të tjerë të njohur; dhe keta përsëri të lidhen me të tjerë të besueshem, kështu që secili prej tyre që bëjnë lidhjen nuk do të dijnë njerëzit, me të cilët janë në lidhje.

Heren e parë duhet me formuar Komitetet e Rretheve me njerëz të sigurt, të cilin komitet do ta pjesëtoni në degë-seksione si përsëmbull: të propagandës, të financave, degën e kabotazhit dhe tjera. Personat e komitetit nuk duhet me i dijt askush, vetëm anëtarët e komitetit mundën me formuar shoqërinë e vetë, por kjo shoqëri nuk duhet me i ditur anëtarët e komitetit.

Përpiçuni që në çdo katund të formoni komitete, por në kujdesin më të madhë se në qoftëse do të kaloni kufirin mundeni me u diktuar dhe do të bini viktima.

Propaganda për armatimin e popullit është një nga pikat më kryesore. Sa të jetë e mundur duhet të mblidhni që të armatoset populli sa më tepër. Armet nuk është e lejueshme me ja dorëzuar armikut, derisa kokën të mos e japim. Armatim bleni sa më shumë, merrni prej popullit ndihma dhe dorëzoni arkëtarit të komitetit financiar. Ndozmat me i mblidh prej njerëzve të sigurt, të cilët nuk kanë me ju diktuar që janë ndihma për komitetin. Ruajuni prej kundërshtarëve tonë. Mblidhuni dhe bleni një radio me akumulator. Në qoftëse nuk na merrni vesh si duhet, atëherë na dërgoni një delegat ose dy ketu në Komitetin e Rahovecit dhe na do iu japim udhëzime e duhuna. Te gjëni ata që nuk janë të komprometuar dhe të dyshimt, dhe që është pak më i zgjuar.

### Situata e jonë politike

Si në Rahovec ashtu edhe në Prizren, në Gjakovë dhe në çdo vend janë formuar Komitetet Nacional Demokratike Shqiptare. Punët shkojnë shumë ngadalë. Lidhjet i kemi nga çdo anë e Kosovës si dhe me Shqipërinë e Vjetër. Radion e kemi. Radio misioni është gati, do të fillojë bisedat me shtetet e huaja. Anglezët kanë marrë vesh për ne

dhe për së shpejti në Shqipëri do të çarmatosen partizanët nga anglezët. Ushtrit e Enver Hoxhës si nga Anglezet ashtu edhe nga amerikanet nuk e kanë njoftuar as nuk e pranojnë dhe do të shkatërohet. Në Serbi është gati kryengritja kundër Titos. Edhe na duhet të jemi gati. Politika ndërmjet Anglezve dhe amerikanëve me Rusët do të prishet, kështu që simbas lajmeve t'ardhuna prej Turqije, keto janë ndamun, kështu që Rusia nuk ka me marrun pjesë në San Francisko më 25 prill 1945, dhe 19 ditë do të mbahet Konferenca e Gjyqit ku do të caktohet kufijt e të gjithë popujve. Gjithashtu nuk do të jet i thirrur as Tita.

Me një fjalë të shkurtër, puna e jonë është shumë mirë, vetëm duhet t'organizohemi dhe në kohën e caktueme të mësyem të gjithë bashku. Delegatin e juaj dërgone sa më shpejt te na, dhe këtij delegati te cilin po jua dergojmë jepni një letër që te dijme se a është i dërguem prej jush. Emnat e juaj duhet të ndërrojnë dhe të zavendsoni me sinonime si psh. Në vend të Jusufit te thoni Fleta, në vend të Hasanit të thoni Shpata. Letrën që keni me na dergje, dergone në emnin tim ose te Lekës, leterpruesi do iu difton se kush jam unë e kush është Leka. Posten gjithashtu sa më parë të na dërgoni.

Letra përfundon me të fala të

përzemërta nga Skenderbegu. Por, poashtu të fala iu dërgonte edhe Leka e Flamuri.

Ndërsa nga letra dilnin edhe porositi të cilat ishin: letrën posa ta merrni ta këndonni dhe menjëherë duhet ta grisni; Fjalët të cilat janë shkruar më sipër ti lexoni mirë dhe me mend dhe ta studioni me kujdes. Besojmë se puna e jonë si dhe veprimi i ynë nuk do të jenë të kota, dhe me pakë mundim do të kemi sukses.

Në këtë pjesë të letrës shtohet se këtë e ka shkruar njëri prej vëllezërve të Flamurit.

Më poshtë letra vazhdon me këto fjalë: Vllait tonë Bardhë Jusufit, Po ju lajmërojmë që Komiteti Demokratik ka filluar nga puna, e cila i është besue. Vetëm që veçanërisht nuk kemi mujt me ardhë në kontakt në disa vende, prandaj jeni të lutun që te vim në lidhje me juve si dhe me të tjerët te na falni që se kemi mujt me ju shkruar, vetëm intersoni me ju diktuar Komiteti Demokratikasht formue ketu në Rahovec si dhe ne te gjithë rrethin.

4 prill 1945, Rahovec.

Te fala prej vëllait juaj Leka.

Prokurorija Publike e Kosovës pasi merr të gjitha aktpadit dhe pasi fillon procesin e hetuesisë ngrit aktakuzën e "famshme", ndaj të arrestuarve të lartpërmendur.

(Fund)

## Kapen 3.5 kilogramë narkotikë në Gjilan, një i arrestuar

GJILAN, 25 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore e Gjilanit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka ndaluar të dyshuarin Sh. Z., i cili dyshohet për kryerjen e veprës penale "blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge".

Prokuroria ka bërë me dije se pas njoftimit të rastit, menjëherë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, me ç'rast, pas bastisjes së shtëpisë dhe lokaleve të tjera përcjellëse në Gjilan, tek i dyshuari janë gje-

tur 3.5 kilogramë narkotikë, që dyshohet të jetë e llojit heroinë. Dyshohet se Sh. Z. ka poseduar këto lëndë narkotike me qëllim të shitjes. Ndaj të njëjtit është marrë aktvendim mbi ndalim në kohëzgjatje prej 48 orësh, si dhe brenda afatit ligjor do të ushtrohet edhe kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet e tjera hetimore me qëllim të ndriçimit të kësaj çështje penale, pasi që dyshohet se është i përfshirë edhe një i dyshuar tjetër, i cili gjendet në arrati.



## Vetëvendosja, aksion simbolik kundër qeverisjes së Ahmetit



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë ka organizuar të dielën një aksion simbolik përmes të cilit është adresuar mungesa e investimeve në stacionet e autobusëve si pjesë e reformimit të transportit publik në Prishtinë.

Aktivistja e kësaj lëvizje, Tropikë Agaj, ka kujtuar se kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, në dy fushatat e kaluara zgjedhore si kandidat i Vetëvendosjes ka pasur prior-

itet reformimin e transportit publik në Prishtinë, duke ditur nevojën e madhe të qytetarëve të Prishtinës për transport cilësor e modern. "Me reformimin e transportit publik, përveç lehtësimit për lëvizje e transport të qytetarëve e banorëve të Prishtinës, qyteti ynë do të lirohej edhe nga ngarkesa në trafik e kjo do të ndihmonte edhe në rritjen e cilësisë së ajrit, çështje e cila është shqetësim serioz kohët e fundit", ka thënë ajo.

Ndërsa asamblisti i Vetëvendosjes, Egzon Azemi, ka thënë se në fushatën e vitit 2013 Shpend Ahmeti pati filluar një aksion simbolik për pritoret e autobusëve, duke përmendur dhe faktin se kjo ka qenë një nga pikat kyçe të programit edhe në vitin 2017. Në mungesë të pritoreve të premtuara dhe shumë të pritura, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vendosur në mënyrë simbolike disa cunga si ulëse për të pritur derisa të vijnë autobusët.

## Macroni: Nuk ka vend për dhunë në republikën tonë

PARIS, 25 NËNTOR - Për të tetën ditë me radhë, me mijëra demonstrues në mbarë Francën protestuan kundër rritjes së çmimit të karburantit.

Ministri i Brendshëm, Christophe Castaner, tha se gjatë këtyre ditëve kishin dalë nëpër rrugët e Francës më tepër se 100 000 protestues, 8 000 prej tyre në Bulevardin e famshëm Champ-Elysees të Parisit. Në mbarë vendin pati 130 të arrestuar. Policia përdori gazin lotsjellës dhe pompat e ujit për

shpërndarjen e protestuesve, të cilët ngritën barrkada dhe shkatërruan semaforët dhe shenjat e trafikut, veprime që shumë vetëve u sollën në mendje protestat e vitit 1968 në kryeqytetin francez.

Presidenti Emmanuel Macron shkroi në Twitter: "Turp për ata që sulmuan policinë. Turp për ata që qenë të dhunshëm ndaj qytetarëve të tjerë. Nuk ka vend për dhunë në Republikën tonë." Protestat patën si shkas rritjen e

taksave dhe rrjedhimisht edhe çmimin e karburanteve dhe Ministria e Transporteve tha se kjo prirje do të vazhdojë në të ardhmen.

Presidenti francez Macron këmbëngul se taksat janë të nevojshme për të pakësuar varësinë e Francës të karburantet fosile, si dhe për të investuar për energjinë e ripërtërishtme. Gjatë kësaj jave, Macroni pritet të bëjë të njohur plane të reja, që synojnë ta bëjnë më të lehtë "transicionin e energjisë".



## BE-ja miraton marrëveshjen e Brexitit me Britaninë

Dokumenti i miratuar të dielën nga udhëheqësit e 27 vendeve përmban edhe një deklaratë politike për përcaktimin e marrëdhënieve të ardhshme në mes të BE-së dhe Britanisë



BRUKSEL, 25 NËNTOR - Bashkimi Evropian arriti ta miratojë të dielën marrëveshjen me kushtet për largimin e Britanisë. Dokumenti i miratuar nga udhëheqësit e 27 vendeve përmban edhe një deklaratë politike për përcaktimin e marrëdhënieve të ardhshme në mes të BE-së dhe Britanisë.

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, njoftoi të dielën përmes Twitterit, se në takimin e mbajtur në Bruksel, të 27 udhëheqësive të Bashkimit Evropian "nënshkruan Marrëveshjen e Tërheqjes dhe Deklaratën Politike mbi të ardhmen e marrëdhënieve në mes të BE-së dhe Britanisë". Presidenti i Komisioni Evropian, Jean-Claude Juncker, foli për

mediet ndërsa qëndronte përkrah Tuskut dhe kryenegociatorit të BE-së, Michel Barnier. "Është një ditë kur jemi të kënaqur me rezultatin e arritur. Por, është një ditë shumë e hidhur. Të shikosh se si një vend si Britania e Madhe kërkon ta gjejë veten larg të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian, duke iu larguar Bashkimit - kjo nuk është një ditë për të ngritur dollin apo për të duartrokatur. Është një ditë pikëllimi, një ndjenjë që

u munduan ta transmetojnë të gjithë që folën, një ndjenjë pothuajse unanime", deklaroi Juncker.

Dokumenti prej 600 faqesh i marrëveshjes përcakton kushtet e largimit të Britanisë nga BE-ja si dhe një plan për lidhjet e tyre në të ardhmen.

Tani kryeministrja britanike Theresa May përballet me sfidën e paraqitjes së marrëveshjes së papëlqyeshme për një numër të madh britanikësh

në Parlamentin e vendit, ku ligjvënësit janë shprehur vazhdimisht me skepticizëm për të. Ajo foli për mediet duke iu drejtuar popullit britanik. "Dua t'i flas tani drejtpërdrejt popullit britanik dhe të shpjegoj se çfarë domethënie ka. Pikë së pari, kontrollin e kufijve tanë. Nuk është një ndalim emergjence i lëvizjes së lirë të njerëzve, apo ndonjë premtim për kontroll më të fortë në të ardhmen, por i jep fund njëherë

e mirë dhe përgjithmonë lëvizjes së lirë. Marrëveshja na lejon të vendosim një sistem emigracioni jo të bazuar te vendet nga vijnë njerëzit, por te aftësitë dhe talentin që vijnë të na ofrojnë. Kjo është në interesin tonë kombëtar", tha May.

May shtoi se pas marrëveshjes Britania do të ndalë pagesat gjigante që i jep çdo vit Bashkimit Evropian dhe do të mundet t'i përdorë këto fonde për prioritetet e saj kombëtare, siç është sistemi i shërbimit shëndetësor. Gjithashtu, marrëveshja heq juridiksionin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Britani dhe lejon që ligjet e vendit të bëhen nga politikanë të zgjedhur në mënyrë demokratike nga populli britanik dhe të zbatohen nga gjykatat britanike.

Që të hyjë në fuqi, marrëveshja duhet miratuar në Parlament. Përndryshe, Britanisë do t'i duhej të largohej nga BE-ja më 29 mars të 2019-ës, pa pasur një marrëveshje që do të zbutte konfliktet në fushën ekonomike. Në një letër të hapur të botuar të dielën nga gazetaret britanike, May u bën thirrje drejtpërdrejt britanikëve, që ta mbështesin marrëveshjen e largimit nga BE-ja, edhe pse është ende e pasigurt përkrahja nga vetë Partia Konservatore e kryeministres britanike.

## Rusia dërgon ekspertë në Alepo pas raportimeve për sulm kimik

MOSKË, 25 NËNTOR - Rusia thotë se ka dërguar ekspertë ushtarakë të kimikateve në Alepo pas raportimeve se pas predhëve të hedhura nga kryengritësit, dhjetëra njerëz kanë pasur probleme me frymë-marrje dhe shikim.

Zëdhënësi i Ministrisë së Mbrojtjes, Igor Konashenko u tha gazetarëve se specialistët nga njësitet ruse për mbrojtje bërthamore, kimike dhe biologjike kanë dalë në vendin e ngjarjes, pasi televizioni shtetëror sirian, ka publikuar pamje ku njerëzit shihen të kenë

pasur probleme, që mund të jenë shkaktuar nga një sulm kimik. "Ata po punojnë me të plagosurit dhe janë duke montuar ambientin në këtë zonë, ku substanca toksike janë përdorur nga militantët", tha Konashenko. "Sipas informacioneve të para, të konfirmuara, sipas simptomave të të lënduarve, predhat e hedhura në zonat rezidenciale në Alepo, duket se kanë qenë të mbushura me klor", shtoi ai.

Agjencia AP ka cituar një zyrtar nga Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut, organizatë me

bazë në Britani, të ketë thënë se kundërmimi i gazit është ndërë në Alepo pas sulmeve më 24 nëntor.

Liderët e rebelëve, megjithatë, kanë hedhur poshtë pretendimet se ata kanë përdorur armë kimike dhe kanë akuzuar zyrtarët qeveritarë se kanë inskenuar këtë sulm për të minuar armëpushimin.

Komandanti i rebelëve, Abdel-Salam Abdel-Razak shtoi se grupet opozitare nuk kanë armë që kanë përmbajtje të gazit dhe madje nuk kanë kapacitete për të sulmuar me armë të tilla.



Të dyja palët e përfshira në konflikt kanë akuzuar njëra-tjetrën se kanë kryer sulme me armë kimike, por këto pretendime

kanë qenë vështirë të verifikueshme për shkak të mungesës së monitoruesve të pavarur.

Recension: Selatin Novosella, "Lamtumirë Baca Adem", ShBPK, Prishtinë, 2018, f. 328

## Libri 'Lamtumirë Baca Adem', një sintezë e shkruar me një stil të qartë

Prof. dr. Ibrahim GASHI

Këto ditë, nën autorësi të z. Selatin Novosella, erdhi në duar e lexuesit shqiptar dhe jo vetëm një përmbledhje e përzgjedhur e impresioneve dhe ekspresioneve të shkruara të pendëve të njohura, të udhëheqësve shtetërorë, të bashkëveprimtarëve, por edhe të qytetarëve të përlotur që janë thënë në tubimet komemorativë dhe gjatë ceremonisë së varrimit të ikonës së patriotizmit shqiptarë të periudhës moderne, të njohur ndër ne si bacë Adem Demaçi dhe nga të huajt si njeriu që me sakrificën personale i dha vulë epokës së shqiptarëve të robëruar, duke i dhënë edhe epitelin krahasues si Mendela i Kosovës.

Autori Selatin Novosella, referuar opusit të tij shkencor e publicistik kushtuar Adem Demaçit, që tashmë i ofrohet si sasi numrit treshifror, me shumë të drejtë mund të quhet jo vetëm bashkë-mendimtar dhe bashkëveprimtar, por edhe biografi ose jetëshkruesi më i njohur i jetës dhe veprës së Adem Demaçit.

Në librin e tij të fundit "Lamtumirë Baca Adem" që po e promovojmë sot autori Novosella na ka sjell një përmbledhje shumë kreative dhe origjinale që përmban gjithë atë që u tha më shumë emocion dhe shpirt nga të gjithë të referuarit në këtë libër, në momentet e dhimbjes së madhe kombëtare të ndarjes nga ne të njeriut që të gjithë i kishim borxh, por ai nuk na kërkoi asgjë, veçse deshi të na shihet të lirë, të bashkuar dhe të zot për të mbrojtur dhe zhvilluar atdheun.

Libri hapet me një testament të Bacës Adem Demaçi, të titulluar "Idetë nuk vdesin kurrë", për të vazhduar në hapje me një epitaft të studiuesit të njohur të folklorit dr. Zymer Neziri, të titulluar: "Baca Adem, ti ishe vetë atdheu". Shkrimi kryesor që hap librin është shkrimi i titulluar: "Në vend të hyrjes" i autorit Selatin Novosella (f. 11-21), për të cilin shkrimi autori, siç shprehet, ishte inspiruar nga fjalët shumë kuptimplota të Shqiptarit dhe Abetares, "baba vdiq i qetë", të thëna vetëm pak minuta pasi pushoi së rrahuri zemra e madhe e bacë Adem Demaçit. Në këtë shkrim me një akribi dhe pasion të


veçantë autori ka bërë disa aludime shumë të argumentuara përse mund të themi se Baca Ademi vdiq i qetë. Sipas tij, kush më shumë se Adem Demaçi do të vdiste i qetë, kur kihet parasysh se ai më shumë se një gjysmë shekulli më parë me mendjen e tij paravajtesë, apo siç do të thoshim sot vizionin e tij, kishte kthjelltësinë të projektojë në mendje rreziqet që duhej të kalonin shqiptarët dhe Kosova, por edhe bindjen e tij të fuqishme se në fund do të realizohej shkëputja nga robëria. Duke shpalosur momentet më kulmore të veprimtarisë atdhetare të bacës Adem, ku ai kishte spikatur me guximin dhe vizionin e tij, i cili ndonjëherë dukej i vështirë, madje i pamundur për t'u realizuar, por më në fund secila nga profecitë dhe idetë të tij u arrit të provohet e saktë dhe e realizueshme deri te çlirimi dhe shkëputja e Kosovës nga sundimi jugosllav dhe serb.

Autori Novosella, duke ruajtur frymën triumfuese demaçiane, e ka nisur edhe përmblyllur këtë shkrim me fjalët Baca Adem vdiq i qetë. Libri është i strukturuar në tre krerë. Kreu i parë i këtij libri përfshinë tri pjesë kryesore. Në pjesën e parë, e titulluar "Mbledhja komemorativë për vdekjen e Bacës Adem Demaçit", (f. 23-34), e mbajtur në Kuvendin e Kosovës, më 27 korrik 2018, sjell fjalimet komemorativë të kryekuvendarit të Kosovës, z. Kadri Veseli, të nënkryetares së Kuvendit të R. së Shqipërisë, të znj. Vasilika Hysi dhe të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi.

Pjesa e dytë e këtij kreu (f. 35-50), e titulluar: "Ceremonia shtetërore për varrimin e Bacës Adem", e organizuar në Sheshin "Skënderbe" në Prishtinë të njëjtën ditë, përmbledhë fjalimet mortore të presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta, kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, të Ali Ahmetit, kryetar i BDI-së dhe fjalimin e Abetares Demaçit të titulluar: "Kisha një baba që e ndava me të gjithë shqiptarët".

Pjesa përmblylëse e këtij kreu (f. 51-55) përmban fjalën lamtumirëse të autorit të këtij libri, z. Selatin Novosella, të lexuar në ceremoninë e varrimit në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë.

Nga një lexim i vëmendshëm i të



gjitha këtyre fjalimeve rezultojnë secili nga shtetarët shqiptarë me fjalë të zgjedhura dhe me pietizëm të thellë iu drejtuan arkivolit të njeriut trupshkurtër, por me zemrën e madhe dhe mendjen rrezatuese i cili po ikën prej kësaj bote, por që pas vetes po linte një testament me përgjegjësi për të gjithë elitën politike shqiptare të sotme, por edhe për atë të nesërme, që të punojnë drejt për ta çuar në vend projektin kombëtar të shqiptarëve. Secili nga këta liderë pa dallim u përkulën me respekt të thellë përpara varrit të Bacës, duke dhënë premtimin e tyre publik se do të ecin rrugës që projektoi dhe e sendërtoi Adem Demaçi.

Kreu i II, i titulluar: "Tubimet - homazhet për Bacën Adem Demaçi" (f. 57-114) përmban gjithë atë që u thanë në tubime homazhe që u mbajtën me rastin dhe pas vdekjes së Adem Demaçit. Autori këtë kapitull e fillon me tubimin homazh të mbajtur më 8 gusht 2018, në ShBPSH, ku fjalimi mortor i mbajtur në këtë tubim nga veprimtari Hydajet Hyseni shpërfaqti më shumë emocion veprën e madhe të simbolit të rezistencës, të kurajës dhe të inspirimit për të gjithë të burgosurit politik shqiptar, bashkëvuajtës të bacës Adem në kazamatet jugosllave. Me përmbajtje të tillë janë edhe tubimet imazhe që mbahen nga Shoqëria Kulturore Artistike "Agimi" në Prizren më 2 shtator 2018, nga Federata Universale e Paqes - Këshilli Shqiptar i Paqes, në Tiranë më dt. 21 shtator 2018, nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, më 21 shtator në Prishtinë. Në fjalimet kryesore që mbajtën në emër të këtyre institucioneve bashkëveprimtarë dhe bashkë-mendimtarë të Bacës Adem si Meriman Braha, Ali Lajçi dhe Abdyl Kadolli, secili në mënyrën më të

përkryer kanë lartësuar figurën emblematike të Adem Demaçit, duke sjell mjaft detaje dhe këndvështrime që më pak i kemi njohur nga vepra jetësore, letrare dhe atdhetare e bacës. Ky krerë përmblyllet me filmin dokumentar të regjisorit Valon Bajrami, prodhim i RTK-së, i titulluar "I pathyeshmi - Adem Demaçi".

Kreu i tretë, i fundit, por mjaft i vëllimshëm dhe përmbajtësor, është titulluar: "Shkrime të veçanta, telegrame dhe përshtypje në librin e zisë", me rastin e vdekjes së Bacës Adem Demaçit" (f. 115-326). Kreu hapet me shkrimin autorial "Mandati i tij, mandat i gjithëkohshëm" i autorit akademik Rexhep Qosja. Në vijim të këtij kreu janë edhe shkrimet filozofia dhe etika politike e Adem Demaçit, të profesor Sabri Kicmarit dhe shkrimi i publicistit Blerim Shala, i titulluar Adem Demaçi dhe ne. Në të tria këto shkrime autoriale nga aspekte dhe këndvështrime të ndryshme, por me interes është trajtuar figura poliedrike e veprimtarit Demaçi, duke provuar me të drejtë që nga secili segment i asaj trajektoreje të bujshme jetësore të tij të nxirren porositë për të sotmen dhe të ardhmen kah duhet të ecim si shtet dhe si komb. Është me interes të shkëputim disa pasazhe nga shkrimi i akademikut Qosja. "Herët në rini ai u bë mësues historik, politik, kulturor, kombëtar e moral i rinisë shqiptare në Kosovë. Ai u bë mësuesi i qëndrimit të drejtë, të papërkulshëm, të dinjitetshëm që nuk e përkulim leverditë, premtimet, kërcimet e burgjet. Ai u bë parathënës i lirisë dhe i pavarësisë së Kosovës.

Ai u bë parathënës i bashkimit kombëtar shqiptar..."

Në vijim të këtij kreu janë përmbledhur edhe telegramet e personalitetëve të shquara si: Sali Berisha,

Edi Rama, Ismail e Helena Kadare, Jakup Krasniqi, Albin Kurti, Xhavit Haliti, Lulzim Basha, Sonja Biserko Latinka Peroviq dhe shume të tjerë. Pjesa e fundit e këtij kreu përmbledh vetëm një pjesë të përshtypjeve të qytetarëve të shkruara në librin e zisë, nga të cilat, para se të veçojmë emra, është e udhës të shkëputim fjalë shumë të përzgjedhura dhe vlerësime tepër të larta për jetën dhe veprën e z. Adem Demaçi. Një nga të nënshkruarit në librin e zisë ka lënë këtë shënim: "Bacë, shkove ashtu siç ishe - i thjeshtë, i madh, i thellë, vizionar, kritik dhe patriot i paepur për t'iu bashkuar legjendave duke lënë gjurmë në mendjen dhe zemrat tona. Të qoftë dhe i lehtë Bacë!" Në një shënim më tej lexojmë: "Më veprimtarinë e tij atdhetare u bë i papërsëritshëm, i paarritshëm dhe i pavdekshëm".

Nga këto shkrime që morëm në shqyrtim në këtë recension promovues shpresoj se kemi arritur të sjellim një përshkrim të mjaftueshëm mbi vlerat e mëdha që përmban ky libër, për ta dëshmuar vëmendjen dhe përkushtimin institucional dhe gjithëpopullor për ta përcjell në mënyrë dinjitoze në përjetësi simbolin e rezistencës kombëtare. Me këtë libër autori ka bërë atë që, në fakt, duhet të bënte secili intelektual që ka pasur fatin të bashkëveprojë dhe bashkëndajë çaste të vështira me të madhin Adem Demaçi.

Duke analizuar me vëmendje këtë përmbledhje monografike, në cilësinë e recensentit, mund të pohoj se libri përmbush në mënyrë të admirueshme kriterin metodologjik dhe përmbajtësor të shkrimeve të këtij formati. Autori ka përdorur një stil narrativ të qartë dhe konfident, të bazuar në burime dhe informacione primare.

Në fund me kënaqësi mund të konstatoj se shkrimet e kësaj natyre dhe të këtij niveli janë një kontribut i çmuar nga lëmi i historisë politike dhe biografive të personalitetëve ndër ne. Libri është një sintezë e shkruar me një stil të qartë dhe me përmbajtje të saktë nga ana intelektuale. E përgëzoj autorin Novosella për kurajën për të mbledhur në një libër, për një kohë rekorde pas vdekjes së Bacës Adem gjithë atë që u përgatit dhe u deklamua në ceremoninë mortore dhe pas saj.

## Skender Muja zë vendin e parë në ekspozitën çmimi "Kadri Kadriu"

MITROVICË, 25 NËNTOR (ER) - Nën organizim të Drejtorisë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Mitrovicës, e për nder të festës së 28 Nëntorit, në Mitrovicë është hapur edicioni i shtatë i ekspozitës mbarëkombëtare Çmimi "Kadri Kadriu", ku të pranishëm

ishin shumë dashamirë të artit figurativ. Ekspozitën e shpalli të hapur Shyqyri Çeliku, kryetar i ShAF të Mitrovicës, ndërsa drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka përshëndetur të gjithë artistët të cilët e nderuan këtë ekspozitë e cila mban emrin e piktorit më të shquar të qytetit.

"Ky është edicioni i shtatë i ekspozitës mbarëkombëtare Çmimi 'Kadri Kadriu', ku po ekspozohen punime shumë të bukura në një frymë moderne dhe po marrin pjesë autorë nga të gjitha trevat shqiptare", ka thënë drejtori Peci.

Ai ka shtuar se për vitin e ardhshëm pritet të ketë inves-

time edhe në galerinë e qytetit. Juria profesionale, pas vlerësimit të të gjitha punimeve të arritura, vendin e parë ia ndau piktorit Skender Muja për punimin "Iluzioni". Vendin e dytë e ndanë Gani Sadiku dhe Aneta Hasani, ndërsa çmimi i tretë iu dha Kushtrim Istrefit për veprën "Portret artisti".



**E jashtëzakonshme**

# Krijohet droni satelit, mjeti fluturues më i madh në botë

Një avion gjigant, me tre bishta e me vetëm njërin krah sa një avion pasagjerësh, është më shumë si dron, por mund ta bëjë punën e satelitit. Ky mjet fluturues, që furnizohet me



energji diellore, mund të qëndrojë në ajër për tre muaj rresht, në mënyrë autonome.

**FOTO E DITES**



Fotografi e realizuar në bjeshkët e Rugovës. /Granit Dinaj/

**E rrallë**

# Vidhet kurora e famshme e dukeshës me vlerë miliona dollarë

Hajdutët kanë përdorur mjete të fuqishme për të thyer një xham të blinduar dhe për të vjedhur një kurorë të mbushur me diamante me vlerë miliona dollarë. Tiara Portland u vjedh në Estate Welbeck në Worksop të



Nottinghamshire. Kurora u krijua për Winifred, Dukeshën e Portland, që ta mbante gjatë ceremonisë së kurorëzimit të Mbretit Edward VII në vitin 1902.

**BARSOLETA E DITËS**



- Zemër, tash që po shkoj në Gjermani, qysh do të flasim?  
- Me "Wester Union", shpirt!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**“NIGHT SCHOOL”**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**“SIBERIA”,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**“VENOM” 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**


 <p><b>DASHI</b> Edhe pse ju kanë dalë disa probleme të vogla financiare kohët e fundit, do të arrini të zgjidhni gjithçka. E rëndësishme është t'i ndani prioritetet.</p>	 <p><b>DEMI</b> Kjo nuk është dita juaj dhe jeni gjithë kohës nën stres. Do të mundoheni t'i menaxhoni emocionet, por shumë e vështirë të ndodhë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Jeni të rrethuar nga njerëz pozitivë dhe që mendojnë vetëm për të mirën tuaj. Kjo gjë ju shtyn të veproni më sigurt.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ditën e sotme keni nevojë për siguri. Këtë gjë do ta kërkontë si nga kolegët e punës, po ashtu edhe nga partneri.</p>	 <p><b>LUANI</b> Një ndjesi plogështie do t'ju shoqërojë sot gjatë gjithë ditës. Është mirë të bëni një kontroll për të parë që çdo gjë shkon mirë me fizikun tuaj.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Edhe pse ju duket sikur të tjerët nuk do t'ju vijnë në ndihmë sot për një problem të caktuar, gaboheni. Miqtë tuaj do të jenë aty për ju.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një debat i ndezur me partnerin që në orët e para të mëngjesit do të ketë pasojat e tij përgjatë gjithë ditës së sotme.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Do t'ju thonë një të vërtetë të hidhur sot që do të parapëlqenit të mos e dinit. Respekti për një person do t'ju humbë përgjithmonë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Keni nevojë për qetësi këto kohë për të menduar më mirë dhe më kthjellët ndryshimet e mëdha që doni të realizoni.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Merrni kohë në dispozicion për t'iu përkushtuar interesave tuaja dhe familjes. Do të shikoni që ju mungonin këto çaste kënaqësie.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot keni probleme përqendrimi sepse doni të zgjidhni disa pune përnjëherësh. Në fund të ditës do të përfundoni duke shkatërruar gjithçka.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot mbase do t'ju tërheqë një ndjenjë që do të tregojë në të ardhmen se është shumë më e fortë sesa që e mendonit.</p>

## Rita falënderon fansat për mbështetjen pas publikimit të albumit



**R**ita Ora aktualisht është e zënë duke promovuar albumin e saj të ri "Phoenix". Këngëtarja 27-vjeçare doli javën e kaluar për të dhënë nënshkrime në albumin e saj në HMV të Liverpoolit, Angli. Më pas, Rita hyri në "Instagram" për t'i

falënderuar fansat për mbështetjen. "Ka qenë një ditë emocionuese deri më tani. Ritabots ju falënderoj për dashurinë dhe mbështetjen tuaj. Ishte ndjenjë e mirë t'ju shihja. Faleminderit të gjithë atyre që e kanë blerë albumin!", ka shkruar Rita.



## Shtëpia e çiftit Beckham, shënjestër për hajdutët

**P**ak muaj më parë hajdutët kishin tentuar të hynin në shtëpinë e çiftit, Victoria dhe David Beckham por, fatmirësisht, nuk arritën. Që nga ky rast çifti kishin vendosur të merrnin më shumë roje në shtëpinë e tyre në Costwolds. Nga revista "The

Sun" është bërë me dije se përsëri hajdutët kishin tentuar të hynin në shtëpinë e çiftit, por që u ndoqën nga shtatë roje dhe dy qen. Për fat të mirë, çifti e as fëmijët e tyre nuk ishin në shtëpi dhe sigurisht nga këto ngjarje ndihen të kërcënuar.

## Ariana Grande vazhdon ta kujtojë ish të dashurin



**A**riana Grande është mirënjohëse për ish të dashurin e saj, Mac Miller. Së fundmi, këngëtarja publikoi një fotografi në 'instastory' të ish-çiftit prej një viti më parë. "Po më mungon", ka

shkruar ajo. 25-vjeçarja e ka kujtuar shpesh ish të dashurin përmes rrjeteve sociale, pas vdekjes së tij në shtator. Disa javë pas vdekjes së tij, këngëtarja u nda nga i fejuari Pete Davidson.

## Erica Hartlein po bëhet nënë



**E**dashura e Jake Owen, Erica Hartlein, është shtatzënë dhe pret fëmijën e parë. Çifti zbuloi lajmin gjatë "I'm Coming Home special" në ABC, javën që lamë pas.

Jake dhe Erica njoftuan se janë në lidhje gjatë muajit prill të vitit të kaluar. Owen është baba i një djali gjashtëvjeçar me ish-gruan Lacey Buchanan.

# Dashuria shkatërruese e Whitmanit

“I dashur Pete! Kam qenë shumë i sëmure tri ditët e fundit, nuk e di si mund ta përshkruaj më mirë gjëndjen time, kjo më ka bërë të ndjehem i dobët dhe i trishtë. Por, kam menduar për ty i dashur, gjithë kohës”. Të shtunën e 21 gushtit 1869, poeti i njohur Walt Wëhitman do të shkruante kështu në rreshtat e parë në letrën drejtuar të dashurit Peter Doyle. “Dashuria ime për ty është e pashkatërrueshme, e ende kam në mendje mëngjeset tona. I dashur Pete! Në agoni në ferrit ku ndodhem vetëm ti më ndriçon. Nuk e di në po mendon për mua...”, vazhonte më tej në letrën e tij Whitman. Me një jetë të trazuar, Whitman e ruajti gjithnjë si të shenjtë jetën e tij private. Vetëm pas vdekjes u zbuluan sirtarët e mbushur me letra dashurie drejtuar burrave që deshi. Një prej tyre ishte Peter, djaloshi që duket që e ka shfrytëzuar dashurinë e tij dhe për tu rimëkëmbur ekonomikisht.

Pasi në një nga letrat Whitman i shkruan se “i kishte dërguar paratë që i duheshin, e më vonë do ti dërgonte të tjera”. I lindur më 31 maj 1819 në Huntington, Long Island (ishullin në formë peshku për të cilin shpesh flet në poezitë e tij, ishulli i dashur dhe i urryer në të njëjtën kohë), nga një familje me të ardhura të kufizuara ekonomike. Whitman vijon të jetë edhe sot një ndër poetët më me ndikim në botën letrare. Babai, ndonëse pa punë të përhershme, lindi nëntë fëmijë. Në anën tjetër, Whitman kishte një lidhje të veçantë me nënën e tij, aq shumë sa që në vdekjen e saj, ai ra në një gjendje të vërtetë dëshpërimi. Disa nga poezitë pesimiste të Whitmanit u shkruan menjëherë pas vdekjes së nënës. Më 1823 familja u transferua nga Brooklin.


Poeti i ardhshëm ishte vetëm katër vjeç. Sa për studimet, Walt ndoqi një rrugë të rregullt deri më 1830, pastaj filloi të mësonte punën e tipografit. Më vonë ai ishte mësues i filllores, vijoi me një mijë gjëra të tjera derisa u bë gazetar (në Amerikë në atë kohë kalimi nga një punonjës shtypshkronje në një gazetar ishte i natyrshëm). Dashuria e tij për shkrim lindi gjatë kësaj periudhe Karriera e tij në botën e shtypit filloi me një bashkëpunim për “Long Islander”, pastaj vazhdoi me “Evening Star” në Brooklin. Në vitin 1841 është drejtor i “Daily Eagle” të Bruklinit, ku ai hyri në “botën e bukur” dhe u bë mik i

piktorëve dhe këngëtarëve të operës. Megjithatë, më 1848, ai u largua nga zyra për shkak të disa dallimeve politike. Iu kthye profesionit të marangozit. Pra, arrijmë në momentin fatkeq që shënon një ndryshim rrënjësor në jetën e poetit.

Njëzet e nëntë vjeç, ai ndjen se ka një jetë të pakënaqshme dhe nuk është në përpjesëtim me atë që vërtet ndien brenda. I vjen dëshira për të udhëtuar, pasi ai kurrë nuk ka vënë këmbë jashtë shtetit të tij. I ofrohet punë në një gazetë në New Orleans: ai pranon. Kështu filloi një bredhjen e gjatë që merr fill në kryeqytetin e Luizianës, një udhëtim nëpër rrugët e kontinentit amerikan dhe përmes lumenjve të saj (p.sh. zbritje përgjatë Misisipit, lum që ka frymëzuar edhe Mark Twain). Shkurtimisht, poeti bie në dashuri me Amerikën, me peizazhet e saj, me burrat e saj dhe me kulturën e tij, të njëjtat elemente që do të frymëzojnë fizicitetin me të cilin janë mbytur vargjet e tij. Më 1833, pas aq shumë vitesh ku pothuaj fare nuk mendohej se ai kishte një të ardhme si poet, vjen botimi i parë i librit “Fije bari”. Libri nuk mban emrin e botuesit as të autorit: përfshin vetëm një portret të Whitmanit në një veshje punëtori dhe përbëhet nga dymbëdhjetë poema pa titull dhe një parathënie. Botimi i dytë vjen më 1836. Këtë herë emri i autorit është në ballinë. Në anën e pasme është letra e Emersonit, i cili përshëndet botimin e parë me një gjykim shumë pozitiv.

Në ditën që festohej pavarësia amerikane, del në dritë kështu një vepër që lartëson shpirtin e atij kombi dhe mrekullitë pjesërisht nëntokësore të botës së re. Jo çuditërisht, për dekada, vepra e Whitmanit është konsideruar si Bibla e demokracisë amerikane, emblema e një shteti në rritje, simbol i forcës që vjen nga lodhja dhe puna. Në poezinë e tij, individit bëhet një komb, vargjet “demokratizojnë”, bëhen fjalë të çdo amerikani: përmbajtja shpreh shpirtin e miliona njerëzve. Me një gjuhë të bukur dhe shumë personale, poeti në tekstet e tij krijon një himn pasionant ndaj mundësive ideale të individit dhe botës, duke festuar hyjninë e natyrës njerëzore dhe mrekullinë e realitetit të përditshëm.

Më 1860 shpërtheu lufta civile, një ngjarje kapitale në historinë e Shteteve të Bashkuara. Të gjithë, edhe nëse në një mënyrë tjetër, përfundojnë duke u përfshirë në këtë dramë të madhe



që sheh gjakun e njerëzve të të njëjtit komb që rrjedhin nëpër rrugë dhe në fshat. Besimi i Waltit në Amerikën e tij është në krizë, por pastaj rimëkëmbet me një moment të përtërirë. Ai vendos të punojë për ushtrinë dhe të shkojë në Uashington (gjithashtu sepse vëllai i tij George është plagosur në betejë). Më 1865 është viti i rizgjedhjes së Lincolnit, por edhe viti i vrasjes së tij. Këto ngjarje frymëzojnë tekstet e “Daullexhinjtë” dhe atë të “Në kujtim të Presidentit Lincoln” dy nga poezitë e tij më të suksesshme. Që nga ky moment,

ka botime gjithnjë e më të shpeshta të veprës tashmë të famshme të Whitmant. Edicioni i katërt dhe i pestë panë dritë në mes të '67 dhe '68 dhe i gjashti në vitin 1876 dhe i shtatë më 1882.

Ndërkohë Whitman bën disa udhëtime: shkoni në St. Louis, atëherë Ontario, për të gjetur Dr. R.M. Bucke i cili do të shkruajë studimin e parë kritik ndaj tij. Më 1873 ai ka një goditje aphopectic, e cila paralajmëroi atë pjesërisht, por, fatmirësisht, ai u shërua. Gjatë vitit nëna vdes, një ngjarje e keqe e cila, siç u përmend më

parë, e hedh atë në dëshpërimin më të errët. Më 1884 ai mori me qira një shtëpi në Mickle Street, në Camden; në 1888 ai ka një tjetër paralizë. Në një krizë ekonomike, fondet gjenden për ta ndihmuar atë. Më 1889 del edicioni i tetë i Fijeve të barit. Në vitin 1891, Whitman filloi përgatitjen e të ashtuquajturit “botimi në shtratin e vdekjes” që doli më 1892. Në të njëjtin vit, më 26 mars, vdiq në moshën 73 vjeçare. Vepra komplete, vargjet dhe proza, u botua në vitin 1902, në dhjetë vëllime.

(gazeta-Shqip.com)



# Fëmijëria që nxiti hakmarrjen e Neronit

Lucius Domitius Ahenobarbus, Neroni i ardhshëm, padyshim ka lindur në Antium (Anzio, qytet i Latiumit të vjetër), më 15 dhjetor të vitit 37 pas Krishtit, gjatë mbretërimit të Kaius-Kaligulës, nëntë muaj pas vdekjes së Tiberit: më 16 mars. Ai lindi në një familje ku klima bashkëshortore nuk ishte aspak e mirë


Kur lindi ai disa shenja paralajmëruese tregonin për karakterin keqbërës të Neronit dhe fatin e kobshëm që e priste popullin e tij. Sipas Suetonit "Midis hamendësimeve të shumta e të frikshme që ishin bërë duke u nisur nga horoskopi i tij, si një profeci bindëse është parë përgjigja e të atit, Drususit, kur e uruan miqtë për djalin: "Nga Agripina dhe unë mund të lindë te vetëm një mostër fatale për botën". Disa shenja paralajmëruese, që ndryshojnë sipas burimeve, shoqërojnë çastet e para të Luciusit. Kështu Suetoni tregon se "Neroni lindi... pikërisht kur po lindëte dielli, dhe rrezet e tij e kapën pothuaj më parë se tokën". Në të vërtetë kjo legjendë është një reminishencë e ritit egjiptian të bashkimit me diskun, sipas të cilit mbreti ose statuja e perëndisë martohej kur lindte dielli, duke u vendosur në pikën më të lartë të faltores ku rrezet e diellit mund ta preknin përpara se të preknin tokën. Kështu, i shënuar me shenjën mbretërore, Neroni princ diellor, i sapolindur, shikohej si i paracaktuar për të mbretëruar mbi Egjiptin dhe mbi Perandorinë, duke qenë njëkohësisht sovran i Romës dhe zoti i mbretërisë së vjetër të Lazhideve. Qoftë që të jenë në përkrahje të Neronit dhe të justifikojnë politikën e tij teokratike dhe antoniane, apo dhe kundër tij dhe të mbështesin përfytyrimin si një perandor mostër, sipas mendimit tonë këto tregime janë vetëm legjenda.

Luciusi i ri do të ketë një fëmijëri të trishtuar dhe të paqëndrueshme. Megjithatë ai vjen nga një familje shumë e vjetër dhe e rëndësishme: për këtë mjafton të theksojmë se i ati i tij, Gnaeus Domitius Ahenobarbus është kushëri i afërt i Julio-Klodianëve dhe kishte ndikim të madh në senat dhe në oborr. Nëna e Luciusit, Agripina e Re, është vajza e Germanikusit, nip dhe bir i adoptuar i perandorit Tiber. Germanikusi ka fituar popullaritet të madh në radhët e ushtrisë, të senatit dhe plebës. Por kjo nuk do ta ndalojë dot

faktin që fëmijëria dhe rinia e Agripinës të jetë e mbushur me aksidente dhe ngjarje tragjike. Dëshmitare e syrgjynosjes, pas-taj e vdekjes së nënës dhe vëllezërve të saj më të mëdhenjtë, kur ishte ende trembëdhjetë vjeçe ajo u martua me Gnaeus Domitius Ahenobarbusin, kushëri i të atit të saj. Origjina dhe jeta e saj e trazuar do t'i ushqejnë ambicien e pangopur dhe etjen e pashuar për pushtet politik, të cilat do ta karakterizojnë këtë femër me bukuri të rrallë deri në fund të jetës.

Neroni ishte vetëm dy vjeç kur e ëma u përzje në komplotin kundër Kaligulës, i organizuar nga Gnaeus Lentulus Getulius dhe Markus Aemilius Lepidius. Më 27 tetor të vitit 39 komploti u zbulua dhe komplotuesit u dënuan. Me urdhër të perandorit, vëllai i saj, Agripina u internua, ndërsa pasuritë iu konfiskuan. I ndarë kështu nga e ëma, Luciusi sapo kishte nisur të ecte në këmbë, u mor në shtëpinë e hallës së tij, Domitia Lepida, motra e të atit, ku qëndroi gati dy vjet. Në vitin 40, një tjetër fatkeqësi ndodh: Neronit i vdes babai. Fëmija është vetëm tre vjeç. Me sa duket, daja i tij Gaiusi, i cili nuk e kishte qejf kunatin, të cilit dikur ia kishte kursyer internimin ashtu siç bëri me gruan e tij, nuk ushqente asnjë ndjenjë dashamirësie ndaj nipit pas dëbimit të Agripinës, ia konfiskoi trashëgiminë (SUET., Ner., 6, 4) Suetoni e vendos dëbimin e Agripinës pas vdekjes së të shoqit: në realitet ngjarjet kanë rrjedhur ndryshe. Tepër i vogël për të kuptuar se çfarë ndodhte rreth tij, Luciusi duhet ta ketë vuajtur këtë, ashtu siç duhej ta duronte atë gjysmëvarfëri ku po rritej, në shtëpinë e hallës së tij (SUET., 6,6). Megjithatë situata do të ndryshojë shumë shpejt: pas ardhjes në pushtet të Klodit, vëllai i Germanikusit, e ëma i kthehet nga internimi. Është viti 41, dhe Neroni është vetëm katër vjeç.

Agripina i rimerr pasuritë dhe besimin politik dhe Neroni trashëgon pasurinë atërore. "Kredia e së ëmës, e cila u thirr



nga mërgimi, dhe mori pasuritë , e ngjiti aq lartë sa që nisën të qarkullonin fjalë se Mesalina, gruaja e Klodit, donte ta mbyste gjatë gjumit, si një rival i rrezikshëm i Britanikusit (SUET., Ner., 6,6, DIO, 60, 4). Pasi tentoi më kotë të martohej me Sulpicius Galbën, perandori i ardhshëm, Agripina martohej me një orator dhe politikan të pasur e me influencë, Gaius Sallustius Crispus Passienus, edhe ai i lidhur me krushqi me familjen mbretërore. Ai njihet nga biografia që i ka bërë atij Suetoni. Më parë, gruaja e tij e ardhshme e ka detyruar të ndahet nga Domitia, motra e Domitius Ahenobarbusit dhe Domitia Lepides, pra vajza e një pasardhësi të familjes perandorake dhe kunatë e Agripinës!

Crispus Passienus ndofta e ka mbrojtur dhe shpëtuar Agripinën, kur motra e tij Livila u internua në vitin 41 pas Krishtit, ashtu siç ka parandaluar vazhdimisht rrufetë e Mesalinës. I bërë konsull zëvendësues—që zëvendësonte konsullin e zakonshëm, ai që i jep emrin e tij vitit të mandatit të tij—në vitin 44, ai vdes ndofta në të njëjtën periudhë. Megjithëse Neroni i ri nuk ishte atëherë veç shtatë

vjeç, sigurisht marrëdhëniet ndërmjet tyre kanë qenë të dyfishta. Sepse, ç'mund të mendonte ky fëmijë për atë që kishte qenë burri i hallës i cili ishte bërë burri i nënës së tij? Të tilla përmbyse të situatës, edhe pse mjaft të shpeshta në ato mjedise në ato kohë, ndofta e futën Luciusin në rrugën hipokrizisë, të mosbesimit, bile të imoralitetit. Ai trashëgoi pasuri nga Passienus Crispus, por ajo nuk i dha kurrë kënaqësi, duke mos e konsideruar aspak si babanë e tij. Por dhe Passienusi nuk kishte asnjë autoritet ligjor mbi atë. Në të vëretë, që nga vitin 41, Luciusi kishte një tutor, Asconius Labeo të cilin Neroni do ta vlerësojë shumë. Një baba i vdekur shumë herët, një nënë në internim ose në Romë, më shumë e preokupuar për sukseset e saj mondane dhe politike, se sa për djalin e saj, e duke vepruar shpesh herë me një ferocia të pamëshirëshme, sipas Tacitit, sigurisht që Luciusi nuk e njohu dhimsurinë dhe ngrohtësinë. Shumë fëmijë të familjeve të mëdha ishin rritur në të njëjtat kushte, por ai ishte me një natyrë tepër të ndjeshme dhe mbartte një trashëgimi të vështirë: si njëra dhe tjetra shpjegojnë, ashtu siç

do ta shohim, disekuilibrin e tij psikik. Kësaj i shtohen dhe ambicet politike, lodra e të cilave i qëlloi të ishte ai. Kështu qarkullonin fjalë të shumta se Mesalina, gruaja e Klodit dhe kushëriria gjermane e Luciusit, kishte dërguar emisarë që ishin ngarkuar për ta vlarë gjatë kohës që ishte në gjumë: por një gjarpër, një draco, ishte ngritur tek koka e krevatit të tij dhe ata ishin larguar. Ngjarja që bëri të lindte kjo fabul është se një ditë, pranë jastëkut të tij u gjet një lëkurë gjarpri. Dhe e ëma ia dha ta mbante disa kohë në një byzlyk floriri në krahun e djathtë.

Më vonë ai e hoqi atë byzlyk që i sillte ndërmend një kujtim të mërzitshëm, dhe kur në çastet e fundit e kërkoi, nuk e gjeti (SUET., Ner., 6, 7-8; TAC., Ann, 11,6; DIO, 61,2,4). Kjo legjendë ndofta e sajuar krejtësisht, tregon për rivalitetin ndërmjet Mesalinës dhe Agripinës, një rivalitet që sigurisht do të ndikonte dhe tek fëmijët e tyre. Pa dyshim që Agripina i inkurajoi përkrahësit e saj që ta shtronin këtë çështje përpara Luciusit, ku ndofta dhe tundën përpara tij lëkurën e gjarprit, të gjetur në dhomën e tij ose të vendosur fshehtas pranë jastëkut.

(gazeta-Shqip.com)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BURNLEY - NEWCASTLE

1

MUNSTER - BRAUNSCHWEIG

1

METZ - AJACCIO GFCO

1

# Feronikeli nuk e shfrytëzon gabimin e Prishtinës

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Derbi i IPKO Superligës së Kosovës në futboll për xhiron e 16-të, në mes të Dritës dhe Feronikelit, përfundoi pa fitues (1-1). Në këtë mënyrë skuadra e Prishtinës vazhdon të jetë lidere në tabelën e klasifikimit me dy pikë më shumë se "Nikli". Llapi e mposhti skuadrën e papërshtatshme, Flamurtarin, dhe në këtë mënyrë mbetet në hap me dy skuadrat e para në garë për titullin e kampiones. KEK-u vazhdon të jetë skuadra më e dobët dhe larg kualitetit të skuadrave të tjera në Superligë.



vojë të madhe në futbollin e Kosovës, Fatih Karahoda, e vulosi rezultatin final 0-3. KEK-u vazhdon të jetë skuadra e vetme që nuk ka shënuar asnjë fitore në këtë kampionat dhe pozicionohet e fundit me vetëm një pikë, ndërsa Liria është e dhjeta me 19 pikë të grumbulluara.

## Drita - Feronikeli 1-1

Feronikeli nuk arriti ta shfrytëzojë gabimin e Prishtinës për ta rrëmbyer pozitën e liderit në Superligë, pasi u nda baras me Dritën, 1-1. Ndeshja e zhvilluar në Gjilan ishte mjaft e fortë dhe skuadrat luftuan shumë për fitore, por rezultati final ishte i barabartë. Ishte skuadra mysafire që realizoi e para nëpërmjet kapitenit Lapidar Lladrovci në minutën e 41-të. Vendësit nuk u dorëzuan dhe në pjesën e dytë e kërkuan me ngulmë golin e barazimit, të cilin e arritën në minutën e 69, kurse Bujar Shabani realizoi gol të bukur për rezultatin 1-1. Pas këtij barazimi Feronikeli mbetet në pozitën e dytë me 36 pikë, një më pak se Prishtina, kurse Drita renditet e pesta me 23 pikë.

## Flamurtari - Llapi 0-1

Fitores në xhiron e gjashtëmbëdhjetë i është gëzuar edhe Llapi që e mposhti Flamurtarin me rezultat 0-1. Vendësit patën dy raste të mira shënimi nëpërmjet Alban Shillovës dhe Lorik Maxhuni, kurse mysafirët, pas disa rasteve të mira, arritën ta shënojnë golin e fitores në minutën e 84-t. Autor ishte mesfushori Behar Maliqi. Llapi pas kësaj fitore e ngushtoi diferencën e pikëve me skuadrën lid-

ere në vetëm pesë pikë, kurse Flamurtari mbetet në kuotën e 22 pikëve.

## Ballkani - Gjilani 4-1

Fitore bindëse të shtunën ka arritur të shënojë skuadra e Ballkanit, e cila e ka mposhtur Gjilanin (4-1). Në këtë ndeshje të parët në epërsi kaluan mysafirët në minutën e 21-të, me autogolin e shënuar nga Elbasan Gashi. Në fund të pjesës së parë vendësit e barazuan rezultatin me golin e shënuar nga Durim Gashi. Në pjesën e dytë futbollistët e Ballkanit mbizotëruan dhe arritën të shënojnë edhe tre gola të tjerë nëpërmjet Blend Baftiut (49), Arbër Potokut (79) dhe Leutrim Gashit (88). Pavarësisht prej humbjes, Gjilani pozicionohet në pozitën e katërt me 24 pikë, kurse ekipi i Ballkanit ka tri pikë më pak dhe renditet në pozitën e tetë.

## KEK-u - Liria 0-3

Fitore si mysafire në xhiron e 16 shënoi edhe Liria e Prizrenit në përballje me skuadrën e KEK-ut nga Kastrioti (0-3). Pas njëzetë minutave lojë, Robert Gjeraj e hapì serinë e golave për 0-1, kurse shtatë minuta më vonë realizoi edhe Blendi Memaj. Në minutën e 65-të sulmuesi me për-

### IPKO SUPERLIGA

Drita - Feronikeli	1-1
Flamurtari - Llapi	0-1
Ballkani - Gjilani	4-1
KEK-u - Liria	0-3
Drenica - Trepça '89	3-0
Ferizaj - Prishtina	0-0

### TABELA

1. Prishtina	37 pikë
2. Feronikeli	36
3. Llapi	32
4. Gjilani	24
5. Drita	23
6. Flamurtari	22
7. Drenica	21
8. Ballkani	21
9. Trepça '89	19
10. Liria	19
11. Ferizaj	15
12. KEK-u	1

### LIGA E PARË

Vushtrria - Onix	1-0
Besa - Kika	1-1
Bashkimi - Vëllaznimi	0-1
Besa - Kika	1-1
Trepça - Vllaznia	3-1
Istogu - Arbëria	2-3
Drenasi - Dukagjini	0-2
Vitia - Fushë Kosova	1-1
2 Korriku - Ramiz Saiku	1-0

### TABELA

1. Vushtrria	35 pikë
2. Besa	32
3. Dukagjini	30
4. Vëllaznimi	29
5. Vitia	28
6. Onix	25
7. Trepça	24
8. Arbëria	22
9. Istogu	17
10. 2 Korriku	17
11. Drenasi	15
12. Kika	15
13. Ramiz Saiku	15
14. Fushë Kosova	14
15. Bashkimi	9
16. Vllaznia	8

### SHKURT

## Kryeziu shënon dy gola, Kololli një

Dyshja e Përfaqësueses së Kosovës, Hekuran Kryeziu dhe Benjamin Kololli, kanë shkëlqyer në ndeshjen që Zurichu ka arritur të marrë një barazim të vlefshëm 3-3 ndaj Xamaxit. Kryeziu e Kololli shënuan golat e ekipit mysafir. Goli i parë nga lojtarët e Kosovës u shënuar nga mesfushori Kryeziu, i cili shënoi nga distanca në minutën e 61-të, për ta ngushtuar epërsinë në 2-1. Kryeziu ishte autor i dy golave, kurse një gol realizoi Kololli. Për këtë të fundit ky ishte goli i gjashtë këtë sezon në Superligën e futbollit të Zvicrës, ndërsa për Kryeziun dy golat e parë.

## Muriqi shënon në Turqi

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, vazhdon të tregojë formë të lartë edhe në skuadrën turke Rizespor. Sulmuesi shtatlartë ka realizuar golin e parë në ndeshje Sivasspor - Rizespor (1-1), kurse për vendësit rezultatin e barazoi David Braz.

## Shënon Kasami, zverdhen Khaka dhe Ajeti

Pajtim Kasami ka realizuar golin e parë në ndeshjen që Sioni e fitoi ndaj Thunit me rezultat 2-1. Kasami luajti gjatë 90 minutave, kurse shqiptari tjetër Ermir Lenjani u zëvendësua në fillim të pjesës së dytë. Në ndeshjen në mes të Luzernit dhe Bazelit, e cila përfundoi 1-1, dy shqiptarët, Taulant Khaka dhe Albjan Ajeti, janë ndëshkuar me karton të verdhë. Për Luzernin luajtën Idriz Voca dhe Shkëlqim Demhasaj.

## Eliminohet Kastrioti

Kastrioti i Ferizajt është ndalur në rrethin e tretë të Kupës Sfiduese (Challenge Cup). Kastriotin e ka eliminuar skuadra belge Vise. Ndeshja e kthimit në mes të Kastriotit e Vises është luajtur të shtunën nga ora 19:00 në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj. Fitore të re shënoi skuadra belge me rezultatin 38:26. Belgët herët nisën të shkëputen në rezultat dhe shënuan fitore bindëse. Të dielën e kaluar në Belgjikë, Vise kishte fituar 33:21. Kjo skuadër kalon në rrethin tjetër të garave. Kastrioti ka arritur sukses historik duke e eliminuar në rrethin e dytë të Kupës Sfiduese Tallinin e Estonisë. Më efikas te Kastrioti ishte Deniz Terziqi me 10 gola. Nga 5 gola i shënuan Rron Ramadani dhe Festim Mustafa.

## Gjymnastika nderon festën e flamurit, ja rezultatet

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Federata e Gjymnastikës e Kosovës ka mbajtur garat finale në gjymnastikën artistike për meshkuj dhe femra. Këto gara janë organizuar për nder të festës së flamurit kombëtar dhe ditëlindjes së komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Adem Jashari. Klubi më i suksesshëm në këto

gara doli "Elita" nga Prishtina. Gjymnastet kryeqytetase rrëmbyen 27 medalje, duke konfirmuar edhe një herë dominimin në gjymnastikën e Kosovës. Vlen të theksohet se një punë të rëndësishme e kanë bërë ekipi i gjyqtarëve të cilët për herë të parë kanë përdorur Kodin e Poentimit në gjymnastikë, normalisht të

modifikuar. Gjyqtarët e vështirësisë (D) dhe Gjyqtarët e ekzekutimit (E). Pavarësisht prej vështirësive që u shfaqën për shkak të mungesës së hapësirës, Federata e Gjymnastikës e vlerëson pozitivisht rrjedhën e garës, ngritjen e cilësisë nga klubet, qasjen pozitive të trajnerëve, interesimin e shikuesve.



## Vëllaznimi rikthen Arlind Bashën

**GJAKOVË, 25 NËNTOR** - Arlind Basha, pas gjashtë vjetëve e gjysmë që e kishte lëshuar Gjakovën, për të shkuar në klubin kroat Hajduku i Splitit, është rikthyer në skuadrën e Vëllaznimit me ndërmjetësimin e menaxherit Besnik Gojani. Ai

nënshkroi kontratë prej një viti e gjysmë (deri në fund të kampionatit 2019-2020). "Jam i lumtur që jam rikthyer aty ku i kam bërë hapat e parë si futbollist. Do të bëjë çmos që ta jap kontributin maksimal që Vëllaznimi të rikthehet aty ku e


ka vendin realisht, në mesin e klubeve më të mira në Kosovë", ka thënë Basha, i cili ka luajtur gjashtë vjet te Hajduku dhe një vjet në Finlandë. Ndërsa kryetari i klubit, Agim Cana, ka deklaruar: "Mendoj se kemi bërë punë shumë të mirë që e

kemi kthyer Bashën në radhët tona, sepse ai këtu e ka vendin, e njëkohësisht me cilësitë që disponon, jemi të bindur se do të jetë ndihmesë e madhe në rrugën e realizimit të qëllimit tonë, rikthimin në elitën e futbollit të Kosovës".



## Hamiltoni e mbylli botërorin me fitore

**ABU DHABI, 25 NËNTOR** - Lewis Hamiltoni fitoi garën e Çmimit të Madh të Abu Dhabi në Formula 1, gara që mbylli Botërorin 2018, me pilotin britanik që bëri një paraqitje të shkëlqyer, duke e merituar këtë triumf. Ai la pas Sebastian Vettelin, ndërsa në podium u ngjiti edhe Max Verstappen me Red Bullin. Pas tre pilotëve të parë u rendit Daniel Ricciardo (i katërti) me makinën tjetër Red Bull e më pas Valtteri Bottasi me Mercedesin (i pesti). Në "top-10" u klasifikuan edhe Sainz (Renault), Leclerc (Sauber), Perez (Force India), Grosjean e Magnussen me Haas. Vetëm i 11-ti Fernando Alonso me McLarenin, në garën e tij të fundit në Formula 1, pas 17 vjetësh karrierë në këtë sport (zgjodhet si piloti më i mirë i garës). Gara nis me surpriza e panik, pas makina Renault e Nico Hulkenberg përmbysset pas një kontakti me Grosjean por, për fat, pa pasojë për pilotin gjerman. Në pistë hyn makina e sigurisë, por i pafat është edhe



piloti finlandez Kimi Raikkonen që pas disa xhirosh u tërhoq, pasi makina e tij Ferrari kishte probleme. Kjo ishte gara e fundit e Raikkonenit me "kokëkuqen", pasi sezonin tjetër do të garojë me Sauberin, raporton "Telesport". Komisarët vendosin regjimin e makinës së sigurisë virtuale, moment kur Hamiltoni hyri në bokse për t'i ndërruar gomat, duke lëshuar kreun, aty ku qëndron Bottasi e pas tij Velteli e Ricciardo. Piloti britanik dhuron spektakël me

Verstappen pas rikthimit në pistë, por Hamiltoni nuk arrin ta parakalojë talentin e ri holandez me Red Bullin që mbrohet mirë. Më pas gara ishte e qetë, pilotët nisin një e nga një ndërrimin e gomave, pa dhuruar parakalime, ndërkohë që i vetmi që vononte ndryshimin e gomave ishte Ricciardo, që i shtyn ato për shumë xhiro. Për një moment krijohet frika se shiu do të jetë protagonist, duke qenë se në rrethinat e pistës së Yas Marina kishte reshje, por jo aty ku garohej.

## Golden State në sekondat e fundit e mposhti Sacramenton



**OAKLAND, 25 NËNTOR** - Skuadra kampione e NBA-s, Golden State, është rikthyer te fitorja, pasi në sekondat e fundit ndaj Sacramentos fitoi me rezultat 117-116. Ai që vendosi fatin e takimit ishte Thompsoni (31 pikë), me një kosh kur kishin mbetur të zhvilloheshin edhe pesë sekonda lojë, ndërkohë që një ndeshje të mirë bëri edhe Duranti që realizoi 44 pikë e 13

rebounde. Vijon paraqitja surprizë e skuadrës së Milwaukee, që arriti fitoren e 14-t sezonale pas suksesit 135-129 ndaj San Antonio. Një ndeshje ku herë kryesonte njëri ekip e herë tjetri, por në pesë minutat e fundit dominuan vendësit, që triumfuan falë 34 pikëve e 18 reboundeve të Antetokounmpo, mbështetur edhe nga tre lojtarë të tjerë që realizuan mbi 20 pikë.

### REZULTATET

Cleveland - Houston	117-108
Minnesota - Chicago	111-96
Oklahoma - Denver	98-105
Washington - New Orleans	124-114
Dallas - Boston	113-104
Golden State - Sacramento	117-116
Milwaukee - San Antonio	135-129

### SHKURT

#### Prishtina e fitoi derbin ndaj Dritës

Skuadra e Prishtinës e ka fituar kryendeshjen e javës së dhjetë të Superligës së Kosovës në hendboll. Prishtina në mbrëmje në Gjilan fitoi ndaj Dritës me rezultat 33:26. Pas pjesës së parë rezultati ishte 12:12, por prishtinasit në pjesën e dytë kishin dukshëm më shumë nga loja. Drita e kishte mposhtur Prishtinën në kryeqytet në javën e parë kampionale, por nuk mundi të fitojë edhe në Gjilan.

#### Bonucci: Ronaldo, lojtari më i mirë në botë

Qendërmbrojtësi i Juventusit, Leonardo Bonucci, e ka lavdëruar bashkëlojtarin e tij, Cristiano Ronaldo, duke thënë se ai është futbollisti më i mirë në botë. "Tani pjesa e vështirë e sezonit fillon nga ndeshjet e fundit të kombëtareve deri në pushimin e dimrit. Ishte e rëndësishme për ne që ta mbajmë distancën prej klubeve të tjera në ligë. Juventus arriti ta transferojë një lojtar të mrekullueshëm si Cristiano Ronaldo. Ai është futbollisti më i mirë në botë dhe është një profesionist shembullor", ka deklaruar Bonucci.

#### Kroosi akuzon mbrojtjen e Realit

Toni Kroos nuk i ka kursyer kritikën për repartin e mbrojtjes dhe thotë se Real Madridi duhet të përmirësohet shumë në këtë aspekt. Mesfushori gjerman e pranon se ekipi nuk ishte në lartësinë e duhur dhe duhet të rikthehet patjetër në ndeshjen ndaj Romës. "Sigurisht se jemi të zhgënjyer me ndeshjen. Nuk ishim mirë dhe Eibari e meritoi plotësisht rezultatin. Është e vështirë të shpjegosh se çfarë ndodhi, por nuk na doli ndeshja siç e kishim parashikuar. Nuk e di nëse është kjo ndeshja më e dobët që kemi bërë. Por duhet të përmirësohemi shumë në mbrojtje. Pësojmë shumë gola dhe të martën na pret një ndeshje e vështirë. Duhet të ndryshojmë dhe të marrim rezultat pozitiv", ka thënë Kroosi.

#### Interi ofron dy yje për Pogban

Garës për transferimin e Paul Pogbas i ka hyrë edhe Interi që dëshiron të ketë në radhët e veta kampionin e Botës, Francën në "Rusi 2018". Lajmi është bërë me dije nga "Sunday Mirror". Trajneri Jose Mourinho është shumë i interesuar për Ivan Perisicqin dhe mbrojtësin Milan Skriniar, prandaj Unitedi është gati ta ofrojë Pogban për dyshen e Interit.

#### Sandro, besnik i Juves

Alex Sandro pritet të qëndrojë te Juventus. Pavarësisht prej interesimit të shumë klubeve për mbrojtësin brazilian, duket se ai tashmë ka vendosur për të ardhmen e tij. Sipas asaj që shkruajnë mediet angleze, 27-vjeçari ka shprehur dëshirën për të qëndruar te kampionët e Italisë. Për mbrojtësin e krahut të majtë interesim kishin shfaqur Chelsea dhe Manchester United, por ofertat e klubeve angleze janë refuzuar nga Juventus.

#### Hazardi mund të largohet nga Chelsea

Ylli i Chelseat, Eden Hazard, raportohet se mund të largohet nga "Stamford Bridge" gjatë afatit kalimtar të janarit. Ai ka shkëlqyer këtë edicion me tetë gola dhe katër asistime në 15 paraqitje. Belgu mbetet dëshirë e flaktë e Real Madridit, ndërsa mbetet pa kontratë në fund të sezonit të ardhshëm. Sipas "OK Diario", Chelsea e ka pranuar se mund ta humbë Hazardin dhe reprezentuesi belg mund të kalojë te gjiganti evropian në fillim të vitit të ardhshëm. "Los Blancos" dëshirojnë ta zëvendësojnë Cristiano Ronaldo e larguar këtë sezon dhe po përjetojnë sezon tejet të vështirë deri tash. Nga 13 ndeshje sivjet në La Ligë, Reali ka pesë humbje dhe është në pozitën e gjashtë me pesë pikë prapa lideres, Barcelonës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister**

**ZYRA E KRYEMINISTRIT** shpallë të lirë këtë vend të punës:

**I. Një (1) Zyrtarë i Lartë për Planifikim të Politikave**  
**Numri i referencës: ZKM-ZPS-005**  
**Koeficienti: 8**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Zyrës për Planifikim Strategjik kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijojnë:

- Merr pjesë në identifikimin, shqyrtimin dhe përpilimin e politikave të Qeverisë, veçanërisht në fushat e politikave ekonomike;
- Ofron këshilla në mënyrë që dokumentet strategjike dhe planifikuese të zhvilluara nga Qeveria të jenë në pajtim me prioritetet e përgjithshme të Qeverisë, përfshirë edhe obligimet që dalin nga procesi i integritetit evropian, si dhe siguron konsistencën dhe ndërlidhjen mes tyre;
- Përfaqëson Zyrën për Planifikim Strategjik në proceset kryesore planifikuese të Qeverisë dhe në veçanti siguron që prioritetet dhe politikave të Qeverisë të pasqyrohen në dokumentet operacionale vjetore, afatmesme si dhe në planifikimin buxhetor të Qeverisë;
- Koordinon punën mes agjencive përkatëse të qeverisë për të siguruar koordinimin dhe integrimin e politikave me objektiva afat-gjata;
- Ofron këshilla në lidhje me rekomandimet që vijnë si pjesë e koncept dokumenteve, të cilat dorëzohen për shqyrtim në Mbledhjen e Qeverisë, dhe që ndërlidhen drejtpërdrejt me politikave dhe prioritetet e Qeverisë;
- Jep kontributet për Planin dhe Raportin Vjetor të Qeverisë nga pikëpamja strategjike dhe e politikave të Qeverisë;
- Kryen analizat për politikave për probleme ndër-sektoriale, të cilat janë njëkohësisht prioritetet qeveritare;
- Ofron ndihmë ministrive për proceset që janë të ndërlidhura me zhvillimin e politikave;
- Sipas kërkesës së Drejtorit, jep këshilla *ad hoc* mbi çështje strategjike të politikave dhe kryen detyra tjera të ndërlidhura me përshkrimin e punës.

**Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë ose ndonjë fushë tjetër përkatëse nga shkencat shoqërore.
- Përvojë pune përkatëse profesionale së paku tri (3) vite në institucionet e Kosovës, në organizata qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare, që veprojnë në Kosovë ose jashtë saj, ose organizata tjera relevante vendore;
- Njohuri të mira të procesit politikbërjes dhe të planifikimit të përgjithshëm strategjik në kuadër të Qeverisë së Kosovës, si dhe të procesit të integritetit evropian.
- Kapacitet intelektual për të kuptuar sfidat ekonomike, sociale dhe të politikave me të cilat ballafaqohet Kosova;
- Aftësi të shkëlqyeshme në hartimin e dokumenteve strategjike, politikave, planeve, analizave, raporteve dhe dokumenteve tjera qeveritare;
- Aftësi të mira organizative, koordinimi, komunikimi, si dhe aftësi për të punuar nën presionin e kohës;
- Njohuri të shkëlqyeshme në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe ose serbe (preferohet të dyja) dhe të gjuhës angleze;
- Njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht në programet e Microsoft Office-it.

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASII-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Tereze p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i TV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e cmërimit sipas LSHIC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

**Afati i konkurrimit është prej datës 26/11/2018 deri me datë 10/12/2018, deri në orën 16:00.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister**

**KANCELARIJA PREMIJERA** objavluje slobodnim sledeće radna mesta:

**I. Jedan (1) visoki zvaničnik za planiranje politika**  
**Broj referencije: UP-KSP-005**  
**Koeficienti: 8**

**Dužnosti i odgovornosti:** pod nadzorom i odgovornošću direktora Kancelarije za strateško planiranje obavlja i vrši sledeće zadatke i odgovornosti:

- Učestvuje na identifikovanju, razmatranju i izradi politika Vlade, posebno u oblasti ekonomskih politika;
- Daje savete kako bi strateški i planerski dokumenti izradeni u vladi bili u skladu sa opštim prioritetima Vlade, uključujući i obaveze koje proizilaze iz procesa evropskih integracija, i obezbeđuje konzistentnost i vezu među njima.
- Zastupa Kancelariju za strateško planiranje u glavnim procesima planiranja Vlade, i posebno obezbeđuje da prioriteti vlade budu odraženi u operacionalnim godišnjim srednjoročnim dokumentima, kao i u planiranju budžeta Vlade.
- Kordiniše rad među relevantnim agencijama vlade, radi obezbeđenja kordinisanje i integrisanje politika kratkoročnih ciljeva;
- Daje savete o preporukama koje slede kao deo koncept dokumenta, koja se dostavljaju za razmatranje na sednici vlade, i koja su u neposrednoj vezi sa politikama i prioritetima Vlade;
- Daje doprinos u godišnjem planu i izveštaju Vlade, sa strateškog pogleda i u pogledu politika Vlade.
- Vršiti analize politika o medusektorskim problemima, koji su istovremeno prioriteti Vlade;
- Pomaže ministarstvima u procesima koji su u vezi sa sa razvojem politika.
- Prema zahtevu Direktora pruža savete *ad hoc*, o strateškim pitanjima politika i obavlja ostale dužnosti u vezi sa opisom poslova.

**Kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:**

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, ili neke druge relevantne oblasti iz društvenih nauka;
- Relevantno radno iskustvo od najmanje (3) tri godina u kosovskim institucijama, međunarodnim vladinim i nevladinim organizacijama koje deluju na Kosovu, ili van Kosova, ili u drugim domaćim relevantnim organizacijama.
- Dobra saznanja o procesu izrade politika, i opšteg strateškog planiranja u okviru Vlade Kosova, kao i procesa evropskih integracija.
- Intelektualni kapacitet za razumevanje ekonomskih, soijalnih izazova, i izazova politika sa kojima se suočava Kosovo;
- Odlične sposobnosti za izradu strateških dokumenata, planova, analiza, izveštaja i ostalih vladinih dokumenata,
- Dobre organizacione sposobnosti, sposobnosti za kordinisanje, komuniciranje, kao i sposobnost za rad pod pritiskom vremena.
- Odlično usmeno i pismeno znanje albanskog ili srpskog jezika, (preferišu se oba) i engleskog jezika.
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru, posebno na programima Microsoft Office.

**OSNOVNI PODACI ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISA**

Kancelarija Premijera pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije od strane svih zajednica na Kosovu.

Ne-većinske zajednice imaju pravo na fer i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe kao što je navedeno u članu 11. stav 3 Zakon br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju se treba priložiti sledeća propratna dokumentacija: popunjeni obrazac za aplikaciju, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju biti verifikovane od strane MONT-a), dokaz radnog iskustva, dve referencë.

Zahtev za zapošljavanje i opis radnog mesta se može dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosovo (ul. Majke Tereze bb). Zvanični obrazac za aplikaciju, možete naći i na web stranici: <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacija mora biti dostavljena Kancelariji za ljudske resurse, zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406. Korišćenje pogrešnog obrazca i nepotpunog sa podacima koji su potrebni, će se smatrati nevažecim.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati koji su ušli u uži izbor će biti kontaktirani. Kandidati koji su izabrani u uži izbor će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZSI, uključujući i period probnog rada je godinu dana.

**Rok za konkurisanje je od dana 26/11/2018 do dana 10/12/2018, do 16:00.**

Prijave pristigle nakon poslednjeg roka konkursa neće biti prihvacene.

Za dodatne informacije, pozovite brojevi: 038 200 14 818 i 038 200 14 817

Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit**Njoftimi për shprehje të interesit**

Shkolla/komuna: **SHFMU „25.maj“ – Donje Ljabinje -Prizren**  
 Data: **26.11.2018.**  
 Emri i kontratës: **Blerje e mjeteve IT**  
 Numri i kontratës: **ESIP/SDG/081-G/1.1**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **SHFMU “25.maj” / Donje Ljabinje - Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**- Blerje e mjeteve IT**

**Llaptop – 2 cope**  
**Projektor – 2 cope**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën **SHFMU “25.maj” – Donje Ljabinje - Prizren** më së largu deri më 04.12.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Asim Karadolami  
**Telefoni:** 044 528 030  
**e-mail:** asim-76@hotmail.com

Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit**Njoftimi për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: “Restelica”  
 Komuna: Dragaš  
 Data: **26.11.2018**  
 Emri i kontratës: Paisje e pjesëshme e kabinetit të TIK  
 Numri i kontratës: **ESIP/SDG/006/ESIP/C1.3/006**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “Restelica”, Dragaš. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

*Lap top Kompjuter – 8 cope*

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Adresa e Shkolles Restelica, Dragash më së largu deri më **04.12.2018** ora 12.00

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit. Detajet kontaktuese të shkollës:

**Detajet kontaktuese të shkollës:**  
**Personi kontaktues:** Jusuf Hodža  
**Telefoni:** 044/532 505  
**E-maili:** onss-restelica@hotmail.com

Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit**Njoftimi për shprehje të interesit**

Shkolla/komuna: **SHFMU „Planjane“ – Planjane -Prizren**  
 Data: **26.11.2018.**  
 Emri i kontratës: **Blerje mjeteve IT**  
 Numri i kontratës: **ESIP/SDG/089-G/1.1**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **SHFMU “Planjane” / Planjane - Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**- Blerje mjeteve IT**

**Tablet – 17 cope**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën **SHFMU “Planjane” / Planjane - Prizren** më së largu deri më 04.12.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Alen Azari  
**Telefoni:** 044 356 448  
**e-mail:** o.s.planjane@hotmail.com

Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit**Njoftimi për shprehje të interesit**

Shkolla/komuna: **SHFMU „Svjetlost“ – Manastirica -Prizren**  
 Data: **26.11.2018.**  
 Emri i kontratës: **Pajisje dhe rekuizita sportive**  
 Numri i kontratës: **ESIP/SDG/090-G/1.1**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **SHFMU “Svjetlost” / Manastirica - Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

**- Pajisje dhe rekuizita sportive**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën **SHFMU “Svjetlost” – Manastirica - Prizren** më së largu deri më 04.12.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Zijad Kulići  
**Telefoni:** 044 833 415  
**e-mail:** o.s.svjetlost@hotmail.com



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



### DOLI NË SHITJE LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ, "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT"

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe

- veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.
- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Beton-Plus" Sh.p.k Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:


### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Harilaç komuna e Fushë Kosovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 24.12.2018 në ora 11:00 në hapësirat e restorantit "Aviano" në magjistrale Prishtinë-Pejë konkretisht në fshatin Sllatinë komuna e Fushë Kosovës do të organizohet debat publik nga kompania "Beton-Plus" Sh.p.k Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Harilaç komuna e Fushë Kosovës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

### Thirrje për aplikim

Preveza Isuf Kelmendi përfituese kërkojmë ofertues /kontraktorë, kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojnë një ofertë propozim për mallrat punët shërbime këshilluese si në vijim: (Ofroni një përshkrim të shkurtër, ndërtim i serrës 5000 m<sup>2</sup> pesë mijë metra katror me material të zinguar).

Kompania e interesuar duhet të kontaktojë direkt tek Preveza Kelmendi nëpërmjet emailit apo telefonit, për të kërkuar një ftesë për kuotim tek adresa e caktuar si më poshtë.

(lejoni 5 dit nga data e publikimit).

Emri i përfituesit Preveza Kelmendi

Adresa sheshi "Adem Jashari" Lipjan, telefoni: 044-315-716

Email:

Oferta/ propozimet duhet të dozohen tek adresa e përfituesit me 27.11.2018. dhjet ditë pasi që ftesa për kuotim të jetë dërguar tek të gjithë ofertuesit-kompanitë e interesuara.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Faton Ninaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Kreshnik Qovanaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Jeta Kiseri shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Dem Belaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Bajram Curri" Romajë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

## NPT AGROKOVRAKA-FRUT

### SHPALL TENDER PER NDERTIMIN E DEPOS

- 1 .PLLAKA DHE IZOLIMET E PLLAKES
2. KONSTRUKSIONI I QELIKUT ME PANEL FRIGO

NUMRI KONTAKTUS 044140588 Kovragë -Istog  
n-azi.b@hotmail.com



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës  
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage - Ministry for the Kosovo Security Force



## **DITA E FORCËS – DITË E HAPUR**

*Forca e Sigurisë së Kosovës, më datë 27 nëntor 2018,  
nga ora 10:00 deri në ora 13:00, organizon  
Ditën e Hapur për nder të Ditës së Forcës.*

**FSK mirëpret qytetarët në të gjitha kazermat e FSK-së, si në  
Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjilan, Prizren, Ferizaj dhe Pomozotin.**

**Vizitorët do të kenë mundësi të shohin pajisje, demonstrime si dhe  
aktivitete të ndryshme të cilat dëshmojnë kapacitetet e FSK-së.**

**Të nderuar qytetarë, ejani të festojmë  
së bashku "DITËN E FORCËS"!**



**Prishtinë, nëntor 2018**